

**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Hartimit të Kurrikulave dhe Materialeve Mbështetëse**

MATERIAL MËSIMOR

Në mbështetje të mësuesve të kualifikimit profesional

SHËRBIME BANKARE

Niveli IV i KSHK

Ky material mësimor i referohet:

Lëndës profesionale: “Teknika bankare”, kl. 12 (L-17-255-25)

Përgatiti:

Albjona Selimi

Anila Nanaj

Ermira Mani

Fabiola Grykshi

Florijs Bega

Tiranë, 2025

Tema 1: Hyrje në sistemin bankar

1.1 Kuptimi dhe funksioni i sistemit bankar

Sistemi bankar është një rrjet i organizuar i institucioneve financiare që operojnë në një vend ose në një rajon dhe që kanë funksionin kryesor të menaxhimit të parasë, kreditimit dhe ruajtjes së kursimeve. Ai përfshin bankën qendrore (apo Bankën e Shtetit) dhe bankat tregtare ose të nivelit të dytë, si dhe institucione të tjera financiare që kryejnë veprime bankare.

Sistemi bankar përbën një nga shtyllat kryesore të ekonomisë së çdo vendi. Ai përfshin të gjitha bankat dhe institucionet financiare që veprojnë në treg me qëllim ofrimin e shërbimeve financiare për individët, bizneset dhe shtetin. Nëpërmjet tij, realizohet qarkullimi i parave, financimi i investimeve dhe ruajtja e stabilitetit ekonomik.

Fjala “bankë” rrjedh nga fjala italiane banco, që do të thotë “stol” ose “tryezë”, sepse në shekujt e mëparshëm tregtarët dhe këmbimtarët e monedhave punonin mbi tryeza në tregje. Me kalimin e kohës, këto veprimtari u organizuan dhe u kthyen në institucione të veçanta që u quajtën banka.

Funksioni themelor i bankave është ndërmjetësimi financiar. Bankat marrin depozita nga individët ose ndërmarrjet që kanë fonde të tepërta dhe i japin hua atyre që kanë nevojë për kapital për konsum, investime apo zhvillim biznesi. Kështu, ato krijojnë një lidhje midis kursimtarëve dhe huamarrësve, duke mundësuar qarkullimin e kapitalit në ekonomi. Më poshtë po tregojmë të ilustruar me foto funksionin e ndërmjetësimit financiar të bankës.

Përveç funksionit të ndërmjetësimit, bankat kryejnë edhe funksione të tjera të rëndësishme, si:

- ✓ Sigurimi i pagesave dhe transfertave – nëpërmjet llogarive bankare, kartave, çekëve dhe sistemeve elektronike.
- ✓ Ruajtja e kursimeve – ofrimi i depozitave me interesa që mbrojnë vlerën e parave të individëve.
- ✓ Krijimi i parasë – përmes procesit të kreditimit, bankat rrisin sasinë e parasë në qarkullim.
- ✓ Mbështetja e zhvillimit ekonomik – duke financuar biznese, prodhime dhe investime publike.

Sistemi bankar është i rregulluar dhe i mbikëqyrur nga shteti për të siguruar funksionim të qëndrueshëm, mbrojtje të klientëve dhe parandalim të krizave financiare. Në Shqipëri, këtë rol e luan Banka e Shqipërisë, e cila është institucioni më i lartë financiar në vend. Sistemi bankar është zemra e ekonomisë moderne. Ai lehtëson qarkullimin e parasë, nxit investimet dhe siguron stabilitetin financiar. Një sistem bankar efikas dhe i sigurt është parakusht për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe mirëqenie të qytetarëve.

1.2 Llojet e bankave dhe funksionet e tyre

Në jetën ekonomike të çdo vendi, bankat luajnë një rol thelbësor. Ato janë institucione financiare që merren me mbledhjen e depozitave nga individët dhe bizneset, dhe me dhënien e kredive për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike. Përmes tyre, kursimet e qytetarëve shndërrohen në investime që nxisin punësimin, prodhimin dhe rritjen ekonomike.

Në sistemin bankar dallohen disa lloje bankash, të cilat ndryshojnë sipas funksionit dhe qëllimit të veprimtarisë së tyre. Në krye të këtij sistemi qëndron Banka Qendrore, që në Shqipëri është Banka e Shqipërisë. Ajo nuk punon drejtpërdrejtë me qytetarët, por me bankat e tjera. Detyra e saj kryesore është të ruajë stabilitetin monetar në vend, të kontrollojë sasinë e parasë në qarkullim dhe të mbikëqyrë aktivitetin e bankave të nivelit të dytë. Ajo përcakton normën bazë të interesit, emeton monedhën kombëtare dhe mban rezervat valutore të shtetit.

Në nivelin e dytë të sistemit bankar ndodhen bankat komerciale ose tregtare, të cilat ofrojnë shërbime për publikun dhe bizneset. Këto banka pranojnë depozita, hapin llogari rrjedhëse, japin kredi për individët dhe bizneset, ofrojnë karta bankare, transfera dhe shërbime të tjera financiare. Shembuj të tillë janë BKT, Raiffeisen Bank, OTP Bank apo Credins Bank.

Një tjetër kategori janë bankat e investimeve, të cilat ndihmojnë ndërmarrjet e mëdha në mbledhjen e kapitalit, në blerjet apo bashkimet e kompanive dhe në emetimin e aksioneve apo obligacioneve. Ato nuk merren me shërbime të përditshme për qytetarët, por me tregjet e kapitaleve dhe investimet afatgjata.

Ekzistojnë edhe bankat e zhvillimit, që financojnë projekte të rëndësishme ekonomike dhe infrastrukturore, si rrugë, energji apo ujësjellës. Disa prej tyre janë me karakter kombëtar, ndërsa të tjera janë ndërkombëtare, si Banka Botërore ose Banka Evropiane e Zhvillimit.

Një formë tjetër janë bankat bashkëpunuese ose kooperativat e kreditit, të cilat krijohen nga një grup anëtarësh që kontribuojnë me kursimet e tyre dhe përfitojnë kredi me kushte të favorshme. Këto banka kanë një karakter më social dhe ndihmojnë anëtarët e komuniteteve lokale.

Në vitet e fundit janë shfaqur edhe bankat online ose neobankat, të cilat ofrojnë shërbimet e tyre vetëm nëpërmjet internetit, pa degë fizike. Klientët i përdorin aplikacionet e tyre për të hapur llogari, për të bërë pagesa, për të kursyer apo për të marrë kredi të vogla. Ky lloj bankimi ka sjellë një revolucion në shërbimet financiare, duke i bërë ato më të shpejta, më të lira dhe më të aksesueshme.

Një kategori e veçantë janë bankat islame, që funksionojnë sipas parimeve të financës islame. Këto banka nuk aplikojnë interes në kuptimin klasik, por punojnë mbi parimin e ndarjes së fitimit dhe humbjes, duke investuar në veprimtari reale ekonomike

1.3 Struktura e sistemit bankar në Shqipëri

Sistemi bankar, në ekonominë e mirëorganizuar dhe që funksionojnë sipas parimeve të tregut të lirë, është i ndarë në dy nivele. Ndarja e sistemit bankar në nivele bëhet për të identifikuar funksionet e ndryshme që kryejnë bankat e nivelit të dytë dhe banka qendrore. Përfshirja e bankës qendrore në nivelin e parë apo e bankave tregtare në nivelin e dytë nuk tregon aspak rëndësinë relative të këtyre institucioneve.

- Në nivelin e parë është banka qendrore. Banka qendrore është një institucion kushtetues i cili, në një këndvështrim të gjerë, ushtron funksione “qeverisëse”. Banka e Shqipërisë është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë.

- Në nivelin e dytë qëndrojnë bankat tregtare. Këto banka janë ndërmjetës të pastër financiarë, të ngritura në formën e shoqërive aksionere dhe që kanë si qëllim sigurimin e fitimit për pronarët e tyre

Sistemi bankar shqiptar është ndërtuar mbi një strukturë me dy nivele, e cila siguron funksionimin e rregullt dhe efikas të tregut financiar. Kjo strukturë përbëhet nga Banka e Shqipërisë në nivelin e parë dhe bankat e nivelit të dytë, që ofrojnë shërbime për publikun.

Në krye të sistemit qëndron Banka e Shqipërisë, e cila është banka qendrore e vendit. Ajo është institucion publik, i pavarur në vendimmarrje, dhe ka për detyrë të ruajë stabilitetin e çmimeve dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar. Funksionet e saj kryesore janë:

- Emetimi i parasë kombëtare, lekut, dhe sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me valutë.
- Hartimi dhe zbatimi i politikës monetare, që synon të mbajë inflacionin nën kontroll.
- Mbikëqyrja e bankave të nivelit të dytë, për të garantuar funksionimin e sigurt dhe ligjor të tyre.
- Menaxhimi i rezervave valutore të vendit dhe kryerja e pagesave ndërkombëtare për llogari të shtetit.
- Këshillimi i qeverisë në politikat ekonomike dhe financiare.

Në nivelin e dytë ndodhen bankat tregtare, të cilat janë institucione private ose publike që operojnë për fitim dhe ofrojnë shërbime për individë, biznese dhe institucione. Këto banka pranojnë depozita, japin kredi, realizojnë pagesa, si dhe ofrojnë produkte të ndryshme financiare, si kartat bankare, transfertat ndërkombëtare, këshillimin financiar etj.

Aktualisht, në Shqipëri veprojnë disa banka të huaja dhe vendase, që ndjekin rregullat e përcaktuara nga Banka e Shqipërisë dhe kontribuojnë në zhvillimin e tregut financiar kombëtar. Përveç bankave tregtare, në sistemin financiar shqiptar funksionojnë edhe institucione financiare jobankare (IFJB), si shoqëritë e mikrokredisë, kompanitë e leasing-ut, shoqëritë e kursim-kreditit dhe shërbimet e pagesave elektronike. Këto institucione ofrojnë produkte financiare më të kufizuara se bankat, por kanë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e bizneseve të vogla dhe në rritjen e përfshirjes financiare të qytetarëve.

Struktura e sistemit bankar në Shqipëri është e ndërtuar në mënyrë të tillë që të garantojë siguri, transparencë dhe efikasitet. Banka e Shqipërisë vepron si mbikëqyrëse dhe rregullatore, ndërsa bankat tregtare dhe institucionet jobankare i shërbejnë drejtpërdrejtë ekonomisë dhe qytetarëve me një gamë të gjerë shërbimesh financiare.

1.4 Marrëdhëniet ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë

Sistemi bankar shqiptar funksionon mbi bazën e bashkëpunimit të ngushtë midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë. Këto marrëdhënie janë thelbësore për ruajtjen e stabilitetit financiar, për mbikëqyrjen e sektorit bankar dhe për zbatimin e politikave monetare që ndikojnë në ekonominë e vendit.

Banka e Shqipërisë është një institucion i pavarur. Misioni i Bankës së Shqipërisë është i thjeshtë: të "luftojë" inflacionin në ekonomi. Sipas ligjit Nr.8269, dt. 23.12.1997, "Për Bankën e

Shqipërisë", "objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është të arrijë dhe të ruajë stabilitetin e cmimeve". Ky objektivi i Bankës së Shqipërisë reduktohet në mbajtjen e inflacionit në shifra pozitive, por në nivele të ulta. Inflacioni pozitiv në nivele të ulta, në pjesën më të madhe të vendeve të zhvilluara, përkthehet në ruajtjen e inflacionit. Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë në ekonomi bëhet gjithnjë në funksion të përmbushjes së këtij objektivi

Në rolin e saj si bankë qendrore, Banka e Shqipërisë ushtron funksione rregullatore dhe mbikëqyrëse mbi të gjitha bankat e nivelit të dytë. Ajo ka të drejtën ekskluzive për të licencuar çdo bankë që dëshiron të ushtrojë veprimtari në territorin shqiptar. Kjo do të thotë se asnjë bankë nuk mund të hapë degë apo të ofrojë shërbime pa miratimin dhe lejen e Bankës së Shqipërisë.

Banka qendrore është garante për stabilitetin e sistemit bankar. Në vija të përgjithshme, banka qendrore e ushtron këtë përgjegjësi në tre hapa:

- licencimi i bankave sipas rregullave të përcaktuara qartë;
- hartimi i bazës ligjore dhe nënligjore që rregullon veprimtarinë e sistemit bankar;
- mbikëqyrja e vazhdueshme e punës së bankave dhe e gjendjes financiare të tyre.

Pasi një bankë merr licencën, ajo mbetet nën mbikëqyrje të vazhdueshme. Banka e Shqipërisë kontrollon nëse bankat tregtare respektojnë ligjet, rregulloret dhe standardet e sigurisë financiare. Për këtë qëllim, ajo kërkon raportime periodike mbi aktivitetin, bilancet, kreditë, depozitat dhe treguesit e qëndrueshmërisë financiare. Këto të dhëna ndihmojnë në vlerësimin e shëndetit të sistemit bankar dhe në parandalimin e krizave.

Një nga marrëdhëniet më të rëndësishme ndërmjet dy niveleve të sistemit është ajo që lidhet me politikën monetare. Banka e Shqipërisë vendos normën bazë të interesit, e cila ndikon në kostot e huave dhe depozitave në bankat e nivelit të dytë. Kur banka qendrore ul normën e interesit, kreditë bëhen më të lira dhe nxitin aktivitetin ekonomik; kur ajo rrit interesin, frenon huadhënien dhe ndihmon në uljen e inflacionit. Kështu, bankat e nivelit të dytë janë zbatuesit praktikë të politikës monetare në tregun real.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është funksioni i bankës së bankave që ka Banka e Shqipërisë. Bankat tregtare mbajnë llogari të tyre pranë Bankës së Shqipërisë, ku kryhen pagesa ndërbankare dhe ruhet një pjesë e rezervave të tyre monetare. Përmes këtyre llogarive, sigurohet likuiditeti i nevojshëm për sistemin e pagesave dhe funksionimi pa ndërprerje i transaksioneve financiare në vend.

Në rastet kur një bankë përballet me vështirësi financiare, Banka e Shqipërisë mund të ndërhyjë me masa rregulluese ose ndihmë emergjente, për të shmangur efektet negative në sistemin e përgjithshëm. Kjo tregon rolin e saj si garant i stabilitetit dhe sigurisë së sistemit bankar.

Marrëdhëniet midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë bazohen në besim, kontroll dhe bashkëpunim të ndërsjellë. Banka qendrore siguron rregullat dhe stabilitetin, ndërsa bankat tregtare zbatojnë politikën në praktikë, duke u shërbyer qytetarëve dhe ekonomisë kombëtare. Ky bashkëpunim është themeli mbi të cilin ndërtohet një sistem bankar i sigurt, i besueshëm dhe modern.

Tema 2. Roli i bankave dhe ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik

2.1 Roli i bankave në qarkullimin e parasë dhe stabilitetin monetary

Paraja është mjeti kryesor që mundëson funksionimin e çdo ekonomie. Ajo përdoret për blerje, shitje, pagesa dhe kursime, duke krijuar lidhje të përhershme midis individëve, bizneseve dhe shtetit. Por që paraja të qarkullojë në mënyrë të rregullt dhe të kontrolluar, është e domosdoshme ekzistenca e një sistemi bankar të mirëorganizuar. Këtu qëndron edhe roli i rëndësishëm i bankave. Bankat janë ndërmjetësit kryesorë në qarkullimin e parasë. Ato marrin depozita nga personat dhe bizneset që kanë teprice parash dhe i japin hua atyre që kanë mungesë kapitali. Kështu, paratë që do të qëndronin të “fjetura” kthehen në burim zhvillimi dhe aktiviteti ekonomik. Në këtë mënyrë, bankat sigurojnë që paraja të lëvizë vazhdimisht, duke mbështetur prodhimin, tregtinë dhe konsumin.

Përveç qarkullimit të parasë, bankat kanë një rol thelbësor në ruajtjen e stabilitetit monetar. Çdo ekonomi ka nevojë për një sasi të caktuar parash në qarkullim – as shumë (sepse shkakton inflacion), as shumë pak (sepse pengon zhvillimin). Bankat ndihmojnë në ruajtjen e këtij ekuilibri përmes politikave të kreditimit, depozitave dhe normave të interesit.

Në këtë proces, Banka e Shqipërisë ka rolin qendror, sepse përcakton normën bazë të interesit dhe kontrollon sasinë e parasë në treg. Bankat e nivelit të dytë, duke ndjekur këto udhëzime, përshtatin veprimtarinë e tyre me kushtet e tregut. Kur Banka e Shqipërisë ul normat e interesit, bankat tregtare japin më shumë kredi, duke shtuar paratë në qarkullim. Kur normat rriten, huadhënia ngadalësohet dhe paraja pakësohet, duke ruajtur stabilitetin e çmimeve.

Një tjetër mënyrë përmes së cilës bankat ndikojnë në qarkullimin e parasë është përmes shërbimeve të pagesave. Ato lehtësojnë transferimet elektronike, përdorimin e kartave, çekëve dhe platformave digjitale që sigurojnë qarkullim të shpejtë dhe të sigurt të parasë. Kështu, ekonomia bëhet më efikase dhe më pak e varur nga paraja fizike.

Si përfundim, roli i bankave në qarkullimin e parasë dhe stabilitetin monetar është themelor për mirëfunksionimin e ekonomisë. Ato sigurojnë lëvizjen e vazhdueshme të kapitalit, ruajnë vlerën e parasë dhe mbështesin qëndrueshmërinë financiare të vendit. Një sistem bankar i shëndetshëm është garanci për një ekonomi të qëndrueshme dhe për mirëqenien e qytetarëve.

2.2 Funksioni i ndërmjetësimit financiar dhe ndikimi i tij në zhvillimin ekonomik

Një nga funksionet më thelbësore të bankave është ndërmjetësimi financiar. Ky funksion përfaqëson aftësinë e bankave për të lidhur kursimtarët, që kanë fonde të lira, me investitorët ose bizneset që kanë nevojë për financim. Nëpërmjet këtij procesi, bankat e vënë paratë në lëvizje, duke e kthyer atë nga një mjet pasiv kursimi në një mjet aktiv investimi.

Në thelb, bankat marrin depozita nga individët, familjet dhe kompanitë që duan të ruajnë paratë e tyre me siguri dhe në të njëjtën kohë japin kredi për ata që duan të zhvillojnë një aktivitet ekonomik. Kjo ndërmjetësi bën të mundur që ekonomia të funksionojë në mënyrë të vazhdueshme dhe që kapitali të shpërndahet aty ku ka më shumë nevojë. Për shembull, një familje që depoziton kursimet e saj në bankë nuk e përdor atë shumë para për konsum të menjëhershëm, por banka i

përdor ato fonde për të dhënë kredi një biznesi që dëshiron të zgjerohet. Si rezultat, krijohen vende të reja pune, rritet prodhimi, dhe përmirësohet cilësia e jetesës së qytetarëve. Kështu, ndërmjetësimi financiar kontribuon drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Nëpërmjet këtij funksioni, bankat ndihmojnë edhe në uljen e kostos së transaksioneve dhe rrezikut financiar. Individët nuk kanë nevojë të kërkojnë vetë se kujt t'i japin hua paratë e tyre; këtë detyrë e merr përsipër banka, e cila vlerëson kredimarrësit dhe siguron kthimin e fondeve me interes.

Një sistem bankar i zhvilluar, me institucione të qëndrueshme dhe politika të kujdesshme, krijon një mjedis të favorshëm për investime, nxit sipërmarrjen private dhe rrit konkurrueshmërinë e ekonomisë kombëtare. Kjo është arsyeja pse ndërmjetësimi financiar konsiderohet një shtyllë e zhvillimit ekonomik në çdo vend modern.

2.3 Roli i bankave në zhvillimin e bizneseve dhe tregjeve

Bankat nuk janë thjesht institucione që ruajnë kursimet e qytetarëve; ato luajnë një rol kyç në zhvillimin e biznesit dhe tregjeve. Përmes shërbimeve të tyre, bankat mundësojnë që sipërmarrjet të rriten, të zgjerohen dhe të konkurrojnë në tregjet vendase dhe ndërkombëtare.

Një nga funksionet kryesore të bankave për bizneset është ofrimi i kredive dhe financimeve. Bizneset e vogla dhe të mesme shpesh nuk kanë kapital të mjaftueshëm për të blerë makineri, për të zhvilluar produkte të reja ose për të zgjeruar aktivitetin. Kredia bankare u jep atyre mundësinë të investojnë, të punësojnë më shumë njerëz dhe të rrisin produktivitetin. Në këtë mënyrë, bankat bëhen katalizator i rritjes ekonomike.

Përveç financimit, bankat ofrojnë shërbime të tjera për bizneset, si:

- Pagesa dhe transfertat bankare, që lehtësojnë marrëdhëniet me klientët dhe furnizuesit;
- Garanci bankare, që u mundëson kompanive të marrin pjesë në tendera ose projekte;
- Shërbime këmbimi valutor, të domosdoshme për bizneset që operojnë në tregjet ndërkombëtare;
- Konsulencë financiare, që ndihmon bizneset të menaxhojnë kapitalin dhe të planifikojnë zhvillimin e tyre.

Ndikimi i bankave në treg është gjithashtu i dukshëm. Kur bankat japin kredi për bizneset, rritet llogaritja e prodhimit dhe furnizimi me mallra dhe shërbime, duke zgjeruar tregun. Bizneset e financuara nga bankat mund të konkurrojnë më mirë dhe të ofrojnë produkte me cilësi më të lartë. Në këtë mënyrë, bankat kontribuojnë jo vetëm në zhvillimin ekonomik të kompanive, por edhe në përmirësimin e cilësisë së tregut dhe konkurrencës.

Një sistem bankar efikas është një faktor kyç për një ekonomi dinamike. Pa bankat që ofrojnë kredi, këshillim dhe shërbime të tjera, shumë biznese nuk do të kishin mundësi të rriteshin, dhe tregjet do të ishin më të ngurtëta dhe më pak konkurruese. Për këtë arsye, bankat nuk janë thjesht depozitues të kursimeve, por partnerë të biznesit dhe motor i zhvillimit ekonomik.

2.4 Ndikimi social dhe zhvillimor i bankave

Bankat nuk ndikojnë vetëm në zhvillimin ekonomik, por edhe në dimensionin social dhe zhvillimor të shoqërisë. Përmes aktivitetit të tyre, ato ndihmojnë në përmirësimin e jetës së

qytetarëve, rritjen e mirëqenies dhe balancimin e zhvillimit ekonomik ndërmjet rajoneve të ndryshme të vendit.

Një nga mënyrat kryesore të ndikimit social është financimi i projekteve që përmirësojnë infrastrukturën dhe shërbimet publike. Bankat mund të ofrojnë kredira ose partneritete financiare për ndërtimin e rrugëve, shkollave, spitaleve dhe projekteve të tjera që sjellin përfitime për komunitetin. Kjo ndihmon jo vetëm qytetarët, por edhe bizneset, duke krijuar një mjedis më të favorshëm për zhvillim ekonomik.

Për më tepër, bankat luajnë një rol të rëndësishëm në përfshirjen financiare të qytetarëve, duke u ofruar shërbime edhe grupeve që tradicionalisht kanë pasur akses të kufizuar, si bujqit, sipërmarrjet e vogla ose individët me të ardhura të ulëta. Përmes llogarive bankare, kredive të vogla, kursimeve dhe edukimit financiar, bankat u mundësojnë atyre të marrin pjesë aktive në aktivitetin ekonomik. Një aspekt tjetër i ndikimit social është promovimi i përgjegjësisë dhe qëndrueshmërisë. Bankat moderne gjithnjë e më shumë financojnë projekte që respektojnë mjedisin dhe kontribuojnë në zhvillim të qëndrueshëm, duke u dhënë shembull qytetarëve dhe biznesve për të ndjekur praktika më të mira sociale dhe mjedisore.

Në përfundim, bankat nuk janë vetëm institucione financiare; ato janë partnerë në zhvillimin e shoqërisë. Aktiviteti i tyre ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e mirëqenies së qytetarëve, në përmirësimin e infrastrukturës dhe në sigurimin e një zhvillimi ekonomik dhe social më të barabartë dhe të qëndrueshëm

2.5 Bankat dhe sfidat e zhvillimit ekonomik modern

Në dekadat e fundit, sistemi bankar ka kaluar një periudhë transformimi të thellë si pasojë e zhvillimeve teknologjike, globalizimit dhe ndryshimeve në mënyrën e jetesës së njerëzve. Bankat nuk janë më thjesht ndërmjetës që ruajnë kursimet dhe japin kredi; ato janë kthyer në institucione dinamike që ofrojnë shërbime të shpejta, të sigurta dhe të personalizuar për çdo klient.

Një nga ndryshimet më të dukshme është dixhitalizimi i shërbimeve bankare. Sot, shumica e bankave ofrojnë bankim online (shërbimet bankare të ofruara përmes internetit) dhe aplikacione mobile, që u lejojnë klientëve të kryejnë veprime financiare në çdo moment dhe nga çdo vend. Pagesat, transfertat, kontrolli i llogarive, aplikimi për kredi apo hapja e një depozite mund të bëhen përmes një telefoni apo kompjuteri, pa qenë nevoja të shkohet në degë bankare. Ky transformim ka rritur ndjeshëm efikasitetin dhe komoditetin për klientët, por ka sjellë edhe sfida të reja lidhur me sigurinë e të dhënave.

Në këtë kontekst, është zhvilluar edhe fusha e FinTech (teknologjia financiare), e cila bashkon teknologjinë me shërbimet bankare. Kompanitë FinTech ofrojnë zgjidhje inovative për pagesa elektronike, kredi të shpejta, këmbim valutash online apo menaxhim financiar përmes inteligjencës artificiale. Bankat tradicionale janë detyruar të përshtaten me këtë realitet të ri, duke bashkëpunuar me këto kompani ose duke zhvilluar shërbimet e tyre digjitale.

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm është siguria dhe privatësia e informacionit financiar. Me rritjen e përdorimit të internetit, rriten edhe rreziqet nga sulmet kibernetike dhe mashtrimet online. Për këtë arsye, bankat po investojnë në sisteme të avancuara sigurie, si autentikimi shumëfaktorësh,(

masë sigurie që përdoret për të verifikuar identitetin e një përdoruesi kur ky futet në llogaritë bankare, shërbimet online ose sisteme të tjera digjitale), kriptimi i të dhënave dhe monitorimi në kohë reale i transaksioneve. Edukimi i klientëve për mënyrat e mbrojtjes së të dhënave të tyre është po ashtu një prioritet.

Përveç aspektit teknologjik, bankat moderne po përqafojnë konceptin e qëndrueshmërisë financiare dhe mjedisore. Ato financojnë projekte që mbrojnë mjedisin, mbështesin ndërmarrjet e gjelbra dhe promovojnë përfshirjen financiare për grupet që tradicionalisht kanë pasur më pak akses në shërbime bankare.

Zhvillimet moderne kanë ndryshuar edhe mënyrën e punës brenda bankave. Proceset janë automatizuar, dokumentet digjitalizohen dhe komunikimi me klientët është bërë më personal falë përdorimit të inteligjencës artificiale dhe analizës së të dhënave. Punonjësit bankarë duhet të zotërojnë jo vetëm njohuri financiare, por edhe aftësi teknologjike e komunikimi.

Në këtë këndvështrim vlen të theksohet se sistemi bankar po përjeton një epokë të re të bazuar në inovacion, shpejtësi dhe siguri. Banka e së ardhmes është ajo që kombinon teknologjinë me besimin, duke ofruar shërbime të thjeshta, të sigurta dhe të aksesueshme për të gjithë

Nga ana tjetër duhet thënë se sistemi bankar modern përballlet me sfida të reja që lidhen me ndryshimet globale, zhvillimet teknologjike dhe krizave ekonomike. Bankat nuk mund të veprojnë më në një mjedis statik; ato duhet të përshtaten me një ekonomi dinamike dhe konkurrencë ndërkombëtare.

Një nga sfidat kryesore është globalizimi i tregjeve financiare. Bankat shqiptare po konkurron me banka të huaja dhe institucione ndërkombëtare, të cilat ofrojnë shërbime të avancuara dhe kushte më të favorshme për klientët. Për këtë arsye, bankat vendase duhet të përmirësojnë shërbimet, të rrisin efikasitetin dhe të ofrojnë produkte konkurruese.

Dixhitalizimi dhe zhvillimet në teknologjinë financiare (FinTech) paraqesin një tjetër sfidë dhe një mundësi njëkohësisht. Bankat tradicionale duhet të investojnë në sisteme digjitale, bankim online, aplikacione mobile dhe sisteme sigurie të avancuara. Në të njëjtën kohë, ato duhet të garantojnë mbrojtjen e të dhënave dhe të parandalojnë mashtrimet online, duke siguruar besimin e klientëve. Bankat gjithashtu duhet të jenë të përgatitura për kriza ekonomike dhe luhatje të tregut monetar. Inflacioni, rritja e borxhit publik ose pasiguria politike mund të ndikojnë në likuiditetin dhe në aftësinë e bankave për të dhënë kredi. Për këtë arsye, bankat duhet të kenë politika të kujdesshme të menaxhimit të rrezikut dhe të ruajnë një rezervë të mjaftueshme për të përballuar situata emergjente.

Një tjetër sfidë është përshtatja me standardet ndërkombëtare të qëndrueshmërisë dhe përgjegjësisë sociale. Bankat duhet të financojnë projekte që respektojnë mjedisin dhe që kontribuojnë në zhvillim të qëndrueshëm, duke u bërë pjesë e një ekonomie moderne dhe të përgjegjshme.

Sfidat e zhvillimit ekonomik modern kërkojnë nga bankat inovacion, fleksibilitet dhe përgjegjësi. Ato duhet të përshtaten me kërkesat e tregut, të përdorin teknologjinë në mënyrë efikase dhe të ofrojnë shërbime të sigurta dhe cilësore. Bankat që arrijnë të përballojnë këto sfida nuk janë vetëm konkurruese, por edhe kontribuojnë në një ekonomi më të fortë, të qëndrueshme dhe të zhvilluar.

Tema 3. Aktiviteti bankar dhe funksionet e tij

3.1 Funksionet bazë të bankave

Për të kuptuar plotësisht avantazhet e procesit të ndërmjetësimit, është e nevojshme të analizohet se çfarë bëjnë bankat dhe si e bëjnë atë. Ne kemi parë se funksioni kryesor i bankave është të mbledhin fonde (depozita) nga njësitë në suficit (kur ka më shumë të ardhura ose fonde sesa shpenzime) dhe t'u japin hua fonde (kredi) njësive në deficit (kur shpenzimet janë më të mëdha se burimet ose të ardhurat).

Depozitat zakonisht kanë karakteristikat e të qenit të vogla, me rrezik të ulët dhe me likuiditet të lartë. Kreditë janë të mëdha, me rrezik më të lartë dhe jolikuide. Bankat mbushin hendekun midis nevojave të huadhënësve dhe huamarrësve duke kryer një funksion transformimi:

- a) transformimi i madhësisë;
- b) transformimi i maturimit;
- c) transformimi i rrezikut.

Bankat janë institucione që luajnë një rol kyç në ekonomi, duke ofruar shërbime financiare që i lehtësojnë jetën qytetarëve dhe biznesit. Funksionet e tyre bazë janë të lidhura ngushtë me ruajtjen e kursimeve, dhënien e kredive dhe qarkullimin e parasë.

Një nga funksionet më të rëndësishme të bankave është marrja e depozitave dhe ruajtja e kursimeve. Individët dhe bizneset që kanë fonde të lira i depozitojnë ato në banka për t'i ruajtur në mënyrë të sigurt dhe për të përfituar interesa. Këto depozita janë burimi kryesor i fondeve që bankat përdorin më pas për dhënien e kredive dhe investimeve.

Funksioni tjetër bazë është dhënia e kredive. Bankat japin kredi për individë që duan të blejnë një shtëpi, një makinë, të financojnë arsimin ose projekte personale. Po ashtu, ato financojnë bizneset që duan të zgjerohen, të blejnë makineri të reja apo të zhvillojnë produkte dhe shërbime të reja. Kjo ndihmon ekonominë të funksionojë më shpejt dhe të krijojë vende pune.

Një funksion tjetër i rëndësishëm është lehtësimi i qarkullimit të parasë dhe i pagesave. Bankat ofrojnë llogari rrjedhëse, karta bankare, sisteme pagese elektronike dhe platforma online që mundësojnë transferimin e shpejtë të fondeve. Kjo redukton përdorimin e parasë fizike dhe bën ekonominë më efikase.

Sa më sipër thamë, kuptohet se funksionet bazë të bankave nuk ndihmojnë vetëm klientët individualë, por ndikojnë gjithashtu në stabilitetin e ekonomisë dhe zhvillimin e tregut financiar. Pa bankat, depozitat nuk do të përdoreshin për investime, kredimarrësit nuk do të kishin qasje në fonde, dhe qarkullimi i parasë do të ishte më i ngadaltë.

Në këto kushte, funksionet bazë të bankave janë themeli i veprimtarisë bankare dhe i zhvillimit ekonomik. Ato krijojnë një lidhje të drejtpërdrejtë midis qytetarëve, bizneseve dhe ekonomisë në tërësi, duke siguruar që resurset financiare të përdoren në mënyrë efektive dhe të dobishme për shoqërinë.

3.2 Funksioni i ndërmjetësimit financiar

Një nga funksionet kryesore të bankave është ndërmjetësimi financiar, i cili lidhet me aftësinë e tyre për të lidhur kursimtarët me kredimarrësit. Në mënyrë të thjeshtë, bankat marrin depozita nga ata që kanë fonde të tepërta dhe i japin hua atyre që kanë nevojë për financim. Kjo veprimtari i lejon ekonomisë të funksionojë në mënyrë më dinamike dhe efektive. Për shembull, një familje që kursen para në bankë nuk i përdor menjëherë për konsumin ditor. Banka përdor këto fonde për të financuar një biznes që dëshiron të blejë makineri, të punësojë njerëz dhe të rrisë prodhimin. Në këtë mënyrë, paratë e kursyera aktivizohen dhe shndërrohen në investime që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik.

Funksioni i ndërmjetësimit financiar ka edhe rolin e menaxhimit të riskut. Bankat vlerësojnë kredimarrësit për të siguruar që paratë e depozituara do të kthehen me interes. Kjo u jep kursimtarëve siguri dhe u mundëson kredimarrësve qasje në kapital që ata ndryshe nuk do ta kishin. Përmes këtij funksioni, bankat ndihmojnë në rritjen e sipërmarrjes dhe zhvillimin e tregjeve. Duke ofruar fonde për investime dhe projekte, ato bëhen katalizator i rritjes së prodhimit, i krijimit të vendeve të punës dhe i avancimit të ekonomisë në tërësi. Pa ndërmjetësimin financiar të bankave, shumë projekte nuk do të realizoheshin, dhe ekonomia do të ishte më e ngadaltë dhe më pak konkurruese.

Funksioni i ndërmjetësimit financiar është një nga shtyllat kryesore të aktivitetit bankar. Ai lidh kursimtarët dhe investitorët, aktivizon kapitalin, menaxhon riskun dhe kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të vendit.

3.3 Shërbimet dhe aktivitetet e bankave për individët dhe bizneset

Bankat ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh dhe aktivitetesh që u mundësojnë individëve dhe bizneseve të menaxhojnë financat e tyre në mënyrë të sigurt dhe efikase. Këto shërbime janë thelbësore për funksionimin e ekonomisë dhe për zhvillimin e sipërmarrjeve.

Për individët, bankat ofrojnë llogari bankare, të cilat mund të jenë llogari rrjedhëse për pagesa të përditshme ose depozita afatshkurtra dhe afatgjata për kursime. Përmes kartave bankare dhe shërbimeve të bankimit online, klientët mund të kryejnë pagesa, të bëjnë transfertat dhe të kontrollojnë llogaritë e tyre në çdo kohë dhe nga çdo vend. Kjo u jep qytetarëve fleksibilitet dhe siguri në menaxhimin e parasë.

Për bizneset, bankat ofrojnë shërbime të veçanta si kredia për zhvillim, garanci bankare, këmbim valutor dhe konsulencë financiare. Kredia u mundëson kompanive të blejnë makineri, të zgjerohen ose të financojnë projekte të reja. Garancitë bankare i lejojnë ata të marrin pjesë në tendera ose projekte të mëdha. Konsulenca financiare ndihmon bizneset të menaxhojnë kapitalin, të planifikojnë investimet dhe të reduktojnë riskun.

Në të dy rastet, aktivitetet dhe shërbimet bankare janë të ndërlidhura me aktivitetin ekonomik dhe zhvillimin e tregjeve. Falë tyre, individët mund të kursejnë dhe të investojnë, ndërsa bizneset mund të rriten, të krijojnë vende pune dhe të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Shërbimet dhe aktivitetet e bankave janë mjeti kryesor për menaxhimin e financave për individët dhe bizneset. Ato lidhin kursimet me investimet, ofrojnë siguri dhe fleksibilitet dhe ndihmojnë në përparimin e ekonomisë dhe zhvillimin e tregjeve.

3.4 Funksioni rregullator dhe social i bankave

Përveç ofrimit të shërbimeve financiare, bankat kanë edhe funksione rregullatore dhe sociale që ndikojnë drejtpërdrejt në stabilitetin e ekonomisë dhe mirëqenien e shoqërisë.

Nga aspekti rregullator, bankat veprojnë nën mbikëqyrjen e Bankës Qendrore, e cila përcakton normat bazë të interesit, kontrollet e likuiditetit dhe standardet e kapitalit. Kjo siguron që aktiviteti i bankave të jetë i qëndrueshëm, që depozitat e qytetarëve të jenë të sigura dhe që kreditimi të kryhet në mënyrë të kujdesshme. Bankat raportojnë rregullisht te Banka Qendrore dhe ndjekin politika për menaxhimin e riskut, duke ndihmuar kështu në stabilitetin e sistemit financiar.

Nga aspekti social, bankat kontribuojnë në përfshirjen financiare të qytetarëve dhe bizneseve që zakonisht nuk kanë qasje të lehtë në kapital. Për shembull, banka mund të ofrojë kredi të vogla për bujqësinë, për sipërmarrjet e vogla apo për individë me të ardhura të ulëta. Përmes edukimit financiar dhe produkteve të përshtatura, bankat mundësojnë që të gjithë qytetarët të marrin pjesë aktive në aktivitetin ekonomik.

Gjithashtu, bankat luajnë një rol në përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ato mund të financojnë projekte që respektojnë mjedisin, që përmirësojnë infrastrukturën lokale ose që ofrojnë mundësi zhvillimi për komunitete të ndryshme. Kjo rrit besimin e qytetarëve dhe kontribuon në një ekonomi më të drejtë dhe të qëndrueshme.

Funksionet rregullatore dhe sociale të bankave janë po aq të rëndësishme sa aktiviteti i tyre ekonomik. Ato sigurojnë siguri, stabilitet dhe përfshirje financiare, duke e bërë sistemin bankar një faktor kyç në zhvillimin e përgjithshëm të vendit dhe mirëqenien e shoqërisë.

3.5 Rëndësia e funksioneve bankare në zhvillimin ekonomik modern

Funksionet bankare janë veprimtaritë kryesore që kryejnë bankat për të përmbushur rolin e tyre në ekonomi. Përmes këtyre funksioneve, bankat sigurojnë qarkullimin e parasë, ruajtjen e kursimeve, dhënien e kredive dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Funksionet e bankave si:

- ❖ depozitat,
- ❖ kreditimi,
- ❖ ndërmjetësimi financiar,
- ❖ shërbimet për individët dhe bizneset,
- ❖ si dhe funksionet rregullatore dhe sociale

janë të lidhura ngushtë me zhvillimin ekonomik modern. Bankat nuk janë thjesht depozitues të kursimeve; ato janë motor i zhvillimit dhe nxitës i aktivitetit ekonomik.

Në një ekonomi moderne, bankat ndihmojnë sipërmarrësit dhe kompanitë të financojnë projekte të reja, të zhvillojnë teknologji dhe të zgjerohen në tregje të reja. Kredia dhe ndërmjetësimi financiar i japin biznesit mundësinë të rrisë produktivitetin dhe të krijojë vende pune. Pa këtë mbështetje, shumë ide dhe projekte nuk do të realizoheshin.

Funksionet bankare janë po ashtu të rëndësishme për stabilitetin financiar. Bankat menaxhojnë riskun, ruajnë besimin e kursimtarëve dhe garantojnë qarkullimin e vazhdueshëm të parasë. Ato

gjithashtu përshtaten me sfidat e ekonomisë globale, duke përdorur teknologji digjitale, bankim online dhe shërbime të avancuara për klientët.

Nga një perspektivë sociale dhe zhvillimore, bankat kontribuojnë në përfshirjen financiare, edukimin financiar dhe zhvillimin rajonal. Ata ofrojnë shërbime dhe financim për grupet që nuk kanë akses të lehtë në burime, duke siguruar që zhvillimi ekonomik të përhapet në mënyrë të barabartë dhe të qëndrueshme.

Funksionet e bankave janë thelbësore për një ekonomi moderne, konkurruese dhe të qëndrueshme. Ato lidhin kursimet me investimet, mbështesin biznesin dhe qytetarët, ruajnë stabilitetin e sistemit financiar dhe nxisin zhvillimin ekonomik dhe social. Pa një sistem bankar të shëndetshëm, ekonomia nuk mund të funksionojë në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme.

Tema 4: Llogaritë rrjedhëse

4.1 Kuptimi i llogarive rrjedhëse.

Llogaria rrjedhëse është një instrument bazë mbi të cilin klienti ndërton marrëdhënien e tij afatgjatë me bankën. Funksioni kryesor i të gjitha llogarive është mbajtja dhe ruajtja në mënyrë të sigurt e parave. Në varësi të llojit, llogaria mund të aksesohet dhe përdoret për veprime të ndryshme bankare. Llogaria rrjedhëse është llogaria më fleksibël, me akses dhe përdorim maksimal.

Çdo marrëdhënie me bankën fillon dhe është e lidhur me llogarinë. Llogaria shërben për të ruajtur në mënyrë të sigurt paratë tuaja dhe për t'i përdorur ato për përdorime të mëvonshme, për të paguar fatura, kredinë apo kartën e kreditit, për të hapur depozita, për të paguar për blerjet me anë të kartës së debitit.

Në thelb, llogaria rrjedhëse është një mjet praktik që lejon mbajtjen dhe qarkullimin e parave në çdo kohë.

Për individët – përdoret për të marrë pagën, për të bërë pagesa të përditshme etj.

Për bizneset – përdoret për të menaxhuar hyrjet dhe daljet e parave në aktivitetin ekonomik.

4.2 Avantazhet e një llogarie rrjedhëse

Avantazhet e të pasurit një llogarie rrjedhëse janë të shumta dhe ofrojnë fleksibilitet, siguri dhe komoditet në menaxhimin e financave personale.

Fleksibilitet - Kur hap një llogari rrjedhëse, klienti ka mundësinë të pajiset me një kartë debiti VISA ose Mastercard, e cila i ofron këtoavantazhe:

- Tërheqje dhe depozitime të leverdishme të parave të gatshme në çdo kohë dhe në çdo vend, përmes rrjetit të gjerë të bankomatëve dhe të gjithë atyre që mbartin logon VISA ose Mastercard, brenda dhe jashtë vendit (jashtë vendit përjashtohen depozitimet).
- Kryerje të pagesave të lehta në të gjitha pikat e shitjes (POS) në Shqipëri dhe jashtë saj.

- Mundësi për pagesa të automatizuara të faturave përmes shërbimit *Pagesa Automatike e Faturave*, që lejon shlyerjen automatike të detyrimeve për shërbime utilitare si energjia elektrike, uji, telefoni, interneti etj., direkt nga llogaria rrjedhëse.

Siguri - Depozitat e klientit në të gjitha bankat janë plotësisht të mbrojtura dhe të siguruara nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave (eëë.asd.gov.al) deri në shumën 2.500.000 lekë, në përputhje me Ligjin nr. 53/2014, datë 22.05.2014, “Mbi Sigurimin e Depozitave”, të ndryshuar.

Komoditet – Llogaritë rrjedhëse ofrojnë komoditet të lartë pasi lejojnë:

- *Pagesa fikse periodike*: Lehtëson kryerjen e transfertave të rregullta drejt palëve të treta nga llogaria rrjedhëse.
- *Kursime elastike*: Mundëson transferta automatike drejt një depozite Flexi, që ndihmon klientin të ruajë fitimet.
- *Kredi konsumatore*: Ofron akses në kredi për nevoja personale.
- *Kredi hipotekore*: Jep mundësi financimi për blerjen e pasurive të paluajtshme.

Pagesa automatike të shërbimeve utilitare (Direct Debit) - Klienti mund të autorizojë pagesa automatike për ofruesit e shërbimeve si: OSHEE, VODAFONE, ONE, ALBTELECOM, DIGITALB, ABCOM, UJËSJELLËSI e të tjera.

4.3 Dokumentacioni i nevojshëm për hapjen e llogarisë rrjedhëse

Dokumentacioni i nevojshëm për hapjen e llogarisë rrjedhëse sipas kategorive të mëposhtme:

Për individët me moshë $\geq$ 18 vjeç, me zotësi të plotë juridike për të vepruar:

- Dokument Identifikimi (Kartë Identiteti, Pasaportë Biometrike)
- KSHBI e firmosur nga klienti (Kontrata e Shërbimeve Bankare Individuale)
- CIF forma e firmosur nga klienti (Dosja e Informacionit të Klientit)
- Formulari i CRS-së (vetëdeklarimit të klientit për rezidencën tatimore) firmosur nga klienti
- Kontratë Llogari Rrjedhëse

Për individët me moshë 16-18 vjeç, me të drejta të kufizuara për të vepruar:

- Dokument Identifikimi (Kartë identiteti, Pasaportë Biometrike)
- Dokument Identifikimi i prindit apo kujdestarit ligjor
- Certifikatë Familjare e 3 muajve të fundit (nevojitet për identifikimin e prindërve)
- KSHBI e firmosur nga vetë klienti dhe prindi apo kujdestari ligjor (Kontrata e Shërbimeve Bankare Individuale)
- CIF forma e firmosur nga vetë klienti dhe prindi apo kujdestari ligjor (Dosja e Informacionit të Klientit)
- Formulari i CRS-së (vetëdeklarimit të klientit për rezidencën tatimore) e firmosur nga vetë klienti dhe prindi apo kujdestari ligjor
- Kontratë Llogari Rrjedhëse

Për individët me moshë 14-16 vjeç, me të drejta të kufizuara për të vepruar:

- Dokument Identifikimi (Certifikatë Personale e 3 muajve të fundit ose Pasaportë Biometrike)
- Certifikatë Familjare e 3 muajve të fundit (nevojitet për identifikimin e prindërve)

- Dokument Identifikimi i prindit apo kujdestarit ligjor
- KSHBI e firmosur nga vetë klienti dhe prindi apo kujdestari ligjor (Kontrata e Shërbimeve Bankare Individuale)
- CIF forma e firmosur nga vetë klienti dhe prindi apo kujdestari ligjor (Dosja e Informacionit të Klientit)
- Formulari i CRS-së (vetëdeklarimit të klientit për rezidencën tatimore) e firmosur nga vetë klienti dhe prindi apo kujdestari ligjor
- Kontratë Llogari Rrjedhëse

Për individët me moshë nën 14 vjeç:

- Dokument Identifikimi (Certifikatë Personale e 3 muajve të fundit ose Pasaportë Biometrike)
- Dokument Identifikimi i Aplikantit (prindi apo kujdestari ligjor)
- Certifikatë Familjare (nevojitet për identifikimin e prindërve)
- CIF forma e firmosur nga prindi apo kujdestari ligjor (Dosja e Informacionit të Klientit)
- Formulari i CRS-së (vetëdeklarimit të klientit për rezidencën tatimore) e firmosur nga prindi apo kujdestari ligjor
- KSHBI e firmosur nga prindi/ kujdestari ligjor /Kontratë Depozite Fëmija Im e firmosur nga prindi/ kujdestari ligjor (Kontrata e Shërbimeve Bankare Individuale)
- Kontratë Llogari Rrjedhëse

Individë me Zotësi të Kufizuar juridike për të vepruar:

- Dokument Identifikimi (Letërnjoftim /Kartë Identiteti, Pasaportë Biometrike)
- Dokument Identifikimi i kujdestari ligjor
- Vendim Gjykatë për emërimin e kujdestarit ligjor
- KSHBI e firmosur nga kujdestari ligjor (Kontrata e Shërbimeve Bankare Individuale)
- CIF form e firmosur nga kujdestari ligjor (Dosja e Informacionit të Klientit)
- Formulari i CRS-së (vetëdeklarimit të klientit) firmosur nga kujdestari ligjor
- Kontratë Llogari Rrjedhëse

Për individë jorezidentë:

- Mjet Identifikimi (Pasaportë, brenda afatit të skadencës, ID, kartë identiteti (vetëm për vendet e BE-së), brenda afatit të skadencës.)
- Leje pune
- Leje qëndrimi
- Kontratë pune
- Kontratë qeraje
- Kodi Fiskal
- KSHBI e firmosur nga klienti (Kontrata e Shërbimeve Bankare Individuale)
- CIF form e firmosur nga klienti (Dosja e Informacionit të Klientit)
- Formulari i CRS-së (vetëdeklarimit të klientit) firmosur nga klienti
- Kontratë Llogari Rrjedhëse

Për individët me shtetësi amerikane:

1. Shtetas amerikanë taksapagues:

- Forma W9 – e cila duhet të jetë e plotësuar saktë në të gjitha fushat e saj (si, Emri, Adresa, TIN) dhe e firmosur nga shtetasi amerikan.
- Deklarata e Pëlqimit – e cila duhet të jetë e plotësuar saktë në të gjitha fushat e saj dhe e firmosur nga shtetasi amerikan.
- Mjet identifikimi
- KSHBI e firmosur nga klienti (Kontrata e Shërbimeve Bankare Individuale)
- CIF form e firmosur nga klienti (Dosja e Informacionit të Klientit)
- Formulari i CRS-së (vetëdeklarimit të klientit për rezidencën tatimore) firmosur nga klienti
- Kontratë Llogari Rrjedhëse

2. Shtetas amerikanë jo taksapagues:

- Forma W8BEN – e cila duhet të jetë e plotësuar saktë në të gjitha fushat e saj (si, Emri, Adresa) dhe e firmosur nga shtetasi amerikan.
- Deklarata e Pëlqimit – e cila duhet të jetë e plotësuar saktë në të gjitha fushat e saj dhe e firmosur nga shtetasi amerikan.
- Mjet identifikimi
- KSHBI e firmosur nga klienti (Kontrata e Shërbimeve Bankare Individuale)
- CIF form e firmosur nga klienti (Dosja e Informacionit të Klientit)
- Formulari I CRS-së (vetëdeklarimit të klientit) firmosur nga klienti
- Kontratë Llogari Rrjedhëse

Për individët që përfaqësohen me prokurë, për përfaqësuesin kërkohet:

- Mjet identifikimi i vlefshëm i përfaqësuesit (Kartë Identiteti, Pasaportë Biometrike)
- KSHBI e firmosur nga klienti (përfaqësuesi) (Kontrata e Shërbimeve Bankare Individuale)
- CIF form e firmosur nga klienti (përfaqësuesi) (Dosja e Informacionit të Klientit)
- Formulari i CRS-së (vetëdeklarimit të klientit) firmosur nga klienti (përfaqësuesi)
- Prokurë e vlefshme

4.4 Hapat që ndiqen për çeljen e një llogarie rrjedhëse

Hapat që ndiqen për çeljen e një llogarie rrjedhëse (monedha, valuta, shërbime shtesë) / për fillimin e marrëdhënies bankë-klient – individ janë:

1. *Zgjedhja e llogarisë dhe aplikimi:* klienti zgjedh llogarinë rrjedhëse dhe aplikon në degën e bankës.
2. *Verifikimi i identitetit:* banka përdor dokument identifikimi të klientit (kartë ID ose pasaportë) për t'u siguruar që klienti është ai që pretendon të jetë.

3. *Plotësimi i të dhënave të nevojshme*: klienti jep të dhëna personale (si emri, mbiemri, atësia, adresa, gjendja civile, numri identifikues, etj), dhe banka mbledh informacion për qëllimin dhe natyrën e marrëdhënies bankare (KYC - Know Your Customer).
4. *Verifikimi online ose në bankë*: BKT ofron edhe mundësinë e regjistrimit digjital («Digital Customer Onboarding») ku skanohet dokumenti i identifikimit dhe bëhet njohja automatike.
5. *Aktivizimi i llogarisë*: pasi përmbushen kërkesat dhe dokumentet, llogaria bëhet funksionale për përdorim – pagesa, transfertë, karta debiti, karta krediti.

Hapat që ndiqen për hapjen e një ***llogarie rrjedhëse për biznes*** (klient juridik, rezident) në Shqipëri, të bazuar në informacionin që banka publikon:

1. *Zgjedhja e produktit dhe kontaktimi me degën / menaxherin e biznesit* – biznesi përcakton se çfarë llogarie i nevojitet (monedha, valuta, shërbime shtesë).
2. *Mbledhja e dokumenteve të biznesit*: regjistrimi i shoqërisë, NIPT, akti themelues ose statut, emrat e përfaqësuesve ligjorë, dokumente identifikimi për përfaqësuesit.
3. *Plotësimi i formularëve të bankës (kontrata për llogari biznesi, formularë KYC/AML (Anti-Money Laundering) për klientin juridik* — përfshirë vetë-deklarimet e klientit si rezidenca tatimore, natyra e aktivitetit ekonomik, burimet e financimit.
4. *Verifikimi i dokumentacionit dhe hapja formale e llogarisë* — banka shqyrton dokumentet, mund të kërkojë verifikim të pronësisë, të burimit të fondeve, të aktivitetit.
5. *Aktivizimi i llogarisë dhe lidhja me shërbimet digjitale* – pasi llogaria aprovohet, biznesi mund të aktivizojë e-Banking, kartat për biznes, funksione e-transfersash dhe shërbime të tjera. Për shembull, dokumenti udhëzues “Hapje Llogarie 1” për biznesit tek BKT e përmend këtë hap.
6. *Përdorimi i llogarisë* – biznesi mund të depozitojë, tërheqë, të bëjë transfertë, të përdorë kartë debiti për biznes, të kryejë pagesa të stafit, furnitorëve etj.
7. *Mirëmbajtja dhe raportimi* – biznesi duhet të mbajë të azhurnuar dokumentacionin e nevojshëm, të respektojë detyrimet e AML/KYC dhe të bankës sipas kushteve të punës së llogarisë për biznes.

Tema 5: Llogaritë e kursimit dhe depozitat me afat

5.1 Kuptimi i llogarive të kursimit

Llogaritë e kursimit dhe depozitat afatgjata janë të dyja llogari bankare që gjenerojnë interes, por ato ndryshojnë në fleksibilitet dhe në normat e interesit. Llogaritë e kursimit ofrojnë akses të lehtë

dhe fleksibël në paratë tuaja, por zakonisht kanë norma interesi të ndryshueshme që mund të luhaten. Depozitat afatgjata (të quajtura gjithashtu depozita me afat ose depozita fikse) kërkojnë që të mbahen paratë e bllokuara për një periudhë të caktuar kohore në këmbim të një norme interesi më të lartë dhe të garantuar, megjithatë tërheqja e parakohshme mund të sjellë penalitete.

Kjo kategori siguron avantazhet e depozitës me afat dhe llogarisë rrjedhëse në një produkt të vetëm:

- Interes më të lartë se llogaria rrjedhëse
- Fleksibilitet më të lartë se depozita me afat

Karakteristikat e llogarive të kursimit:

- Mund të depozitohen dhe tërhiqen para sa herë të doni
- Ndryshe nga Llogaria Rrjedhëse, këtu mund të përfitohet interes mbi balancën ditore të llogarisë.
- Ndryshe nga Depozita me Afat, në llogaritë e kursimit nuk është nevoja të përcaktohet një periudhë për të pakësuar ose shtuar shumën.
- Menaxhohen paratë tuaja në mënyrë optimale.

Të gjitha llogaritë e depozitave të çdo depozituesi individ, tregtar dhe shoqëri tregtare, rezident ose jorezident, shqiptar ose i huaj, i cili ka llogari depozitë në një bankë, në lekë ose në monedhë të huaj sigurohen nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD), deri në nivelin 2.500.000 (dymilion e pesëqindmijë) lekë ose e njëvlershmja e saj në monedhë të huaj, sipas dispozitave të përcaktuara në ligjin nr. 53 datë 22.05.2014, “Për Sigurimin e Depozitave” i ndryshuar.

Llogaria e kursimit ose depozita pa afat është një llogari me karakteristika të veçanta midis llogarisë rrjedhëse dhe depozitës me afat.

5.2 Llojet e depozitave me afat

Depozitat me afat janë një nga format më të sigurta të kursimit dhe investimit në banka. Ato janë marrëveshje mes klientit dhe bankës për investim për një kohë dhe shumë të caktuar kundrejt një norme interesi. Këto lloj depozitash janë të përshtatshme për individët që duan të ruajnë kursimet e tyre me një kthim të sigurt dhe të parashikueshëm.

Depozitat klasike ashtu siç i njohim të gjithë kanë karakteristikat e mëposhtme:

- Depozita me afat që ofrohen për 1, 3, 6 muaj dhe 1, 2, 3 vjet.
- Depozita me afat të cilat mund të hapen në monedhat Lek (ALL), Euro (EUR), Dollar Amerikan (USD), Paund Britanik (GBP), Dollar Kanadez (CAD), Franga Zvicerane (CHF), Dollar Australian (AUD), etj.
- Interesi përfitohet në datën e maturimit të depozitës dhe humbet nëse kjo e fundit tërhiqet përpara afatit.
- Depozita me afat ofron opsionin e rinovimit automatik. Ju mund të zgjidhni që interesi i fituar të rinovohet bashkë me depozitën ose të kalojë në llogarinë tuaj.

Bazuar në ligjin “Për Sigurimin e Depozitave” nr. 53/2014, date 22.05.2014, llogaritë dhe depozitat në BKT sigurohen deri në shumën 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë për individin nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave

Llojet kryesore të depozitave me afat:

Depozitat afatshkurtra - Afati zakonisht varion nga 1 deri në 12 muaj. Norma e interesit është zakonisht më e ulët se në depozitat afatgjata, pasi periudha është më e shkurtër. Përshtatet për ata që duan të kenë likuiditet të shpejtë, por edhe duan të fitojnë një interes mbi kursimet e tyre.

Depozitat afatmesme - Afati zakonisht është 1 deri në 3 vjet. Këto depozita ofrojnë një normë interesi më të lartë krahasuar me depozitat afatshkurtra. Ato janë të përshtatshme për individët që duan të rrisin kursimet e tyre duke mos i përdorur për disa vite dhe duke fituar një normë më të lartë interesi.

Depozitat afatgjata - Afati zakonisht është mbi 3 vjet dhe mund të variojë edhe nga 5 ose 10 vjet. Ato ofrojnë normë interesi më të lartë dhe përshtaten për individët që duan të ruajnë një shumë të madhe parash për një periudhë të gjatë dhe të maksimizojnë fitimin nga interesi.

Karakteristikat e depozitave me afat:

- Paratë zakonisht nuk mund të tërhiqen para maturimit të afatit.
- Depozitat me afat janë të sigurta dhe shpesh të mbrojtura nga fondet e sigurimit të depozitave të shtetit, duke minimizuar rrezikun e humbjes së kapitalit.
- Sa më i gjatë afati i depozitës, aq më e lartë është norma e interesit, duke e bërë këtë një mundësi tërheqëse për kursyesit afatgjatë.

Përfitimet e depozitave me afat:

- Siguri dhe stabilitet për kursimet.
- Interes i parashikueshëm dhe shpesh më i lartë se llogaritë e zakonshme të kursimit.
- Përfitim i mundshëm nga stimuj dhe bonuse të ofruara nga banka për afate më të gjata.

Disa tipe të tjera investimesh në formën e depozitave me afat mund të jenë:

Depozita elastike – Afati përcaktohet nga 40 në 360 ditë dhe nga 737 në 1095 ditë. Depozita elastike mund të hapet në monedhat Lekë (ALL), Euro (EUR), Dollar Amerikan (USD), Paund Britanik (GBP), Dollar Kanadez (CAD), Franga Zvicerane (CHF) ose Dollar Australian (AUD). Interesi përfitohet në datën e maturimit të depozitës dhe humbet nëse kjo e fundit tërhiqet përpara afatit. Depozita elastike është e pa-rinovueshme automatikisht.

Depozita rekord - Ofrohet për 5 ose 7 vjet në Lekë dhe për 2, 3, 4, 5 vjet në Lekë, Euro ose Dollar Amerikan. Norma e interesit mbi depozitën rekord është vendosur që në momentin e parë dhe përfitimi nuk preket nga ndryshimet e normave të interesit në treg. Interesi përfitohet çdo 6 muaj dhe do të kthehet nëse depozita tërhiqet përpara afatit. Depozita rekord është e pa-rinovueshme automatikisht.

Depozita matrushka është zgjedhja më e mirë për të përfituar interesa në rritje, por edhe fleksibilitet në tërheqje pa humbur interesat e përfituara. Kjo depozitë ofrohet për një afat 6 vjeçar në tre monedhat Lekë, Euro ose Dollar Amerikan.

Depozita StepUp ofrohet për një afat 2 vjeçar në monedhat Lekë, Euro, Dollar Amerikan dhe Paund Britanik. Interesi përfitohet çdo fund 6-mujori dhe nuk ka detyrim kthimi edhe nëse depozita tërhiqet përpara afatit 2 vjeçar. Nuk rinovohet automatikisht.

5.3 Hapat për çeljen e depozitave me afat

Hapat për hapjen e depozitave me afat janë të njëjta në pothuajse të gjitha bankat, sepse bazohen në:

- procedurat e përbashkëta bankare,
- rregulloret e përgjithshme të Bankës së Shqipërisë,
- mënyrën se si funksionojnë llogaritë e depozitave kudo në sistemin bankar.

Çelja e një depozite me afat është një proces i thjeshtë, që mund të bëhet në degë ose online. Hapat kryesorë janë:

1. *Informimi dhe zgjedhja e produktit* - Klienti informohet për llojet e depozitave me afat, normat e interesit, afatet dhe kushtet e bankës. Më pas zgjedh depozitën që i përshtatet më shumë objektivave të tij financiare.
2. *Përzgjedhja e afatit dhe monedhës* - Klienti zgjedh periudhën (p.sh. 1, 3, 6, 12 muaj) dhe monedhën e depozitës (ALL, EUR, USD, etj.).
3. *Plotësimi i aplikimit / kontratës* - Plotësohet formulari i hapjes së depozitës ose firmoset kontrata përkatëse. Banka kërkon dokument identifikimi dhe burimin e fondeve.
4. *Depozitimi i shumës* - Klienti transferon nga llogaria e tij ose dorëzon në sportelet e bankës shumën që do të vendoset në depozitë.
5. *Konfirmimi i hapjes* - Banka lëshon dokumentin e depozitës me detajet përkatëse si: afati, norma e interesit, shuma, data e maturimit dhe mënyra e veprimit në maturim.

5.4 Operacionet që mund të kryhen me depozitat me afat

Me një depozitë me afat mund të kryhen këto operacione:

1. Rinovimi në maturim

Kur depozita arrin datën e maturimit, banka i jep klientit mundësinë që ajo të rinovohet automatikisht për të njëjtën periudhë dhe me kushte të ngjashme me ato fillestare. Ky proces ndodh pa pasur nevojë që klienti të ndërhyjë, nëse ai e ka dhënë këtë instruksion paraprakisht. Megjithatë, klienti mund të kërkojë që në momentin e maturimit shuma e depozitës, së bashku me interesin e përfituar, të transferohet në llogarinë e tij rrjedhëse, duke mbyllur në kështu mënyrë depozitën me afat.

2. Ndryshimi i depozitës në afatin e maturimit

Në ditën e maturimit të depozitës, klienti mund të përcaktojë se si dëshiron të veprojë me depozitën e kursimit. Ai mund të zgjedhë ta rinovojë për të njëjtën periudhë, ta mbyllë dhe t'i transferojë të gjitha fondet në llogarinë e tij, ose të rinovohet vetëm principi i depozitës ndërsa interesi të kalojë në llogarinë rrjedhëse. Këto zgjedhje bëhen zakonisht pak ditë para afatit për të siguruar që depozita të menaxhohet sipas nevojave të klientit.

3. Tërheqja para afatit

Klienti mund të vendosë të tërheqë depozitën përpara përfundimit të afatit të maturimit. Në një situatë të tillë, depozita mbyllet menjëherë dhe shuma i kthehet klientit, por zakonisht ai humbet një pjesë ose edhe të gjithë interesin e akumuluar, në varësi të politikave të bankës. Ky operacion përdoret vetëm në raste kur klienti ka nevojë urgjente për fondet.

4. Kontrata e depozitës

Në çdo moment gjatë ekzistencës së depozitës, klienti mund të kërkojë nga banka një kontratë zyrtare që vërteton hapjen e depozitës, shumën e saj, afatin dhe të gjitha detajet përkatëse. Ky dokument shërben si provë juridike ose financiare dhe përdoret shpesh për çështje administrative ose përpara institucioneve të ndryshme. Kontrata e depozitës është dokument i rëndësishëm pasi klienti për çdo veprim me bankën duhet të paraqesë këtë kontratë. Në rast humbje apo dëmtimi të kontratës klienti duhet të paraqitet menjëherë pranë sporteleve të bankës për të deklaruar humbjen e kontratës dhe për të marrë një dublikatë të saj. Në rastin kur kontrata e depozitës është dy-emërore duhet të paraqiten të dy titullarët e saj.

5. Cash Collateral / Bllokim i depozitës

Disa banka u ofrojnë klientëve mundësinë që depozita me afat të përdoret si garanci për një kredi. Në këtë rast, depozita bllokohet për kohën që klienti ka detyrime ndaj bankës, duke i mundësuar atij të marrë hua me kushte më të favorshme. Ky proces njihet si “cash collateral” dhe e rrit sigurinë e bankës, pasi depozita shërben si kolateral.

6. Transferimi i interesit

Interesi që gjeneron depozita mund të trajtohet në mënyra të ndryshme, në varësi të preferencës së klientit. Ai mund të kapitalizohet, pra t'i shtohet shumës fillestare të depozitës dhe të rrisë principalin në rinovim, ose mund të transferohet automatikisht në një llogari tjetër të klientit, zakonisht atë rrjedhëse, në mënyrë që ai të përfitojë menjëherë nga interesi.

7. Konsultime dhe modifikime teknike

Gjatë periudhës së ekzistencës së depozitës, klienti mund të kërkojë ndryshime teknike dhe administrative, si përditësimi i të dhënave personale, modifikimi i llogarisë ku kreditohet interesi

ose informime të detajuara rreth normave të interesit dhe ekuilibrit të depozitës. Këto shërbime synojnë të garantojnë që depozita të menaxhohet saktë dhe të jetë gjithmonë në përputhje me nevojat dhe të dhënat aktuale të klientit.

Tema 6: Produktet bankare

6.1 Produktet bankare: Llogaritë bankare

Produktet bankare janë mjetet dhe shërbimet financiare që bankat u ofrojnë individëve dhe bizneseve për të menaxhuar paratë e tyre, për të lehtësuar transaksionet dhe për të ofruar kredi. Këto ndahen në mënyrë të përgjithshme në llogari depozitash, produkte kredidhënieje dhe shërbime investimi / menaxhimi pasurie.

Llojet e llogarive bankare

Këto produkte përdoren për të ruajtur paratë në mënyrë të sigurt dhe për të menaxhuar financat e përditshme.

Llogari rrjedhëse - Funkcioni kryesor i të gjitha llogarive është mbajtja dhe ruajtja në mënyrë të sigurt të parave. Në varësi të llojit, llogaria mund të aksesohet dhe përdoret për veprime të ndryshme bankare. Llogaria rrjedhëse është llogaria më fleksibël, me akses dhe përdorim maksimal. Ato zakonisht nuk ofrojnë interes. Llogaritë rrjedhëse mund të përdoren për veprime të ndryshme bankare si: depozitime dhe tërheqje, transfera brenda dhe jashtë vendit, pagesa për të tretët, pagesa fature, debitim direkt (pagesa automatike fature), pagesa periodike (në shuma fikse, brenda BKT-së), pagesë kredie, pagesë karte krediti.

Llogari kursimi - Lejojnë individët të ruajnë paratë e tyre me siguri dhe të fitojnë interes mbi to. Janë të përshtatshme për krijimin e fondeve emergjente ose për kursime për qëllime të ardhshme. Kjo kategori siguron avantazhet e Depozitës me Afat dhe Llogarisë Rrjedhëse në një produkt të vetëm:

- Interes më të lartë se llogaria rrjedhëse
- Fleksibilitet më të lartë se depozita me afat

Llogari depozite - Përfshijnë depozitimin e një shume të caktuar për një periudhë të paracaktuar kohe, në këmbim të një norme interesi më të lartë se një llogari kursimi e zakonshme.

Llogari studenti - Llogari rrjedhëse që i ofrohet studentëve pa komision. *Statusi i studentit përfitohet deri në moshën 25 vjeç*. Pas kësaj moshe, klienti do të trajtohet sipas kushteve standarte të bankës.

Llogari page - Llogari bankare ku punëmarrësi merr rrogën e tij çdo muaj. Përdoret për tërheqje, pagesa dhe menaxhim të përditshëm të financave.

Llogari kredie - Llogari që hapet nga banka për të administruar një kredi të dhënë klientit. Në këtë llogari pasqyrohet shuma e huasë, këstet dhe interesat që duhet të paguhen.

Llogari garancie - Llogari e veçantë ku bllokohet një shumë parash si garanci për një detyrim, kredi ose kontratë. Shuma qëndron e ngrirë deri në përmbushjen e kushteve të marra përsipër.

Llogari pensioni - Llogari rrjedhëse pa komision e dedikuar për të marrë pagesën mujore të pensionit. Ajo u mundëson pensionistëve të kenë akses të sigurt dhe të rregullt në të ardhurat e tyre, duke kryer tërheqje, pagesa dhe veprime të tjera bankare pa vështirësi. Nëse llogaria rezulton mbi 2 vjet inaktive do të klasifikohet automatikisht si llogari standarte.

6.2 Produktet bankare: Produktet e kredidhënies

Llojet e produkteve të kredidhënies

Këto produkte u lejojnë klientëve të marrin hua, ndërsa banka fiton të ardhura nga interesi që ngarkohet mbi kredi.

Kredi personale

***Kredi personale** janë kredi të pasiguruara që ofrojnë një shumë të caktuar për përdorime personale, si rinovime banese, pushime ose shlyerje borxhesh. Disa nga llojet e kredive personale janë si më poshtë:*

Super kredia - Super kredia është një kredi personale, e synuar për t'u aksesuar shumë lehtë nga klientët që kanë të ardhura nga paga, qira në sistemin bankar dhe gjithashtu të ardhura nga aktiviteti privat. Nëpërmjet super kredisë synohet të përmbushen nevojat personale më të nevojshme të klienteve.

Kredia EKO - Kredia EKO është një lloj kredie që ofrohet për të financuar produkte, pajisje ose projekte me efikasitet energjetik dhe ndikim pozitiv në mjedis. Ky financim përdoret zakonisht për: instalimin e paneleve diellore, izolimin termik të banesës, pajisje elektro-shtëpiake me kursim energjie, sisteme ngrohjeje më ekonomike, investime të tjera që reduktojnë konsumin e energjisë.

Paradhënie bankare (Overdraft) – Paradhënia bankare është një marrëveshje me bankën që i lejon klientit të shpenzojë më shumë para sesa ka aktualisht në llogarinë e tij rrjedhëse, deri në një kufi të caktuar të miratuar paraprakisht. Kjo shumë shtesë funksionon si një kredi afatshkurtër, që përdoret për të mbuluar shpenzime urgjente ose mungesa të përkohshme likuiditeti. Klienti paguan interes vetëm për shumën e përdorur dhe për sa kohë e mban të pashlyer. Overdraft-i mundësohet vetëm për klientët pagamarrës.

Kredia për pensionistë - Kredia për pensionistë është një lloj kredie e ofruar posaçërisht për personat që marrin pension. Kjo kredi përdoret për shpenzime të ndryshme personale, mjekësore, familjare apo të përditshme, dhe zakonisht ka interesa të arsyeshme dhe afate fleksibël pagese, duke marrë parasysh moshën dhe mundësinë e kthimit të huasë nga pensioni mujor.

Kreditë hipotekore

Kreditë hipotekore janë kredi të siguruara për blerjen e pasurive të paluajtshme, ku vetë prona shërben si kolateral. Nëpërmjet kredive hipotekore synohet të përmbushen nevojat personale të individëve për blerje, ndërtim ose rindërtim të një prone rezidenciale, por edhe të individëve të cilët janë profesionistë të vetëpunësuar të tillë si: (mjek, dentist, farmacist, avokat etj) të cilët dëshirojnë të blejnë ose ndërtojnë ambjentet e tyre të punës apo individëve që gjenerojnë të ardhura nga punësimi dhe që dëshirojnë të blejnë një njësi me qëllime investimi (dhënie me qera). Llojet e kredive hipotekore janë:

Kredi hipotekore vetëm interes - Një kredi ku klienti paguan vetëm interes gjatë disa viteve të para të kredisë duke bërë pagesa më të ulëta mujore. Pasi të përfundojë periudha vetëm me interes, klienti do të fillojë të paguajë interesin dhe principalin. Kjo kredi ofrohet vetëm në monedhën Lek.

Kredi për shtëpi - Është një hua afatgjatë e dedikuar për blerjen, ndërtimin ose rinovimin e një banese rezidenciale. Ofron shuma të mëdha financimi, këste të përballueshme dhe afate të gjata kthimi, pasi sigurohet zakonisht me hipotekë.

Kredi për blerje / ndërtim dyqani - Është një kredi e orientuar drejt biznesit, e cila përdoret për të blerë ose ndërtuar një njësi tregtare. Kjo kredi mbështet zhvillimin e aktiviteteve ekonomike dhe zakonisht kërkon kolateral (si vetë dyqani ose një pasuri tjetër) dhe një plan të qëndrueshëm pagese.

Kredia Flexi Hipotekore - Kredia Flexi Hipotekore i jep klientit liri më të madhe në menaxhimin e buxhetit, duke e bërë më të lehtë zotërimin dhe shlyerjen e një prone rezidenciale. Gjatë kohëzgjatjes së kredisë, kredimarrësi përballlet me ndryshime periodike të normave të interesit (si pasojë e ndryshimit të normave të Bonos së thesarit), duke përballuar kështu pagesa të ndryshme çdo vit.

Kredi niveli zero - Financimi nëpërmjet produktit "Zero Level" bën të mundur që individët të financohen për një pronë, bazuar në marrëveshjen që banka ka me një shoqëri ndërtimi, pa qënë i nevojshëm ofrimi i një pasurie si kolateral nga ana e individit (përfshirë raste të veçanta). Si garanci mund të vendoset shtëpia që do të blihet dhe që është ende e pahipotekuar.

Kredia për emigrantët - Kredia për emigrantët është një kredi e krijuar enkas për të gjithë ata që jetojnë dhe punojnë jashtë Shqipërisë për t'i mundësuar përmbushjen e nevojave të tyre për blerje/ndërtim shtëpie ose dyqani apo për rregullim shtëpie ose dyqani por edhe individëve profesionistë të vetëpunësuar (mjek, dentist, farmacist, avokat etj) të cilët duan të blejnë, ndërtojnë apo rregullojnë ambjentet e tyre në Shqipëri.

Kredi konsumatore me kolateral

Kredi konsumatore me kolateral është një formë huaje që u jepet individëve për të financuar nevoja personale (si blerje të mëdha, udhëtime, shpenzime familjare apo rregullime shtëpie,

dyqani), por që kërkon vendosjen e një garancie të sigurt, zakonisht pasuri të paluajtshme, automjet, depozita bankare ose tjetër aset me vlerë. Vendosja e kolateralit ul rrezikun për bankën, ndaj zakonisht ofron interesa më të ulëta, afate më të gjata kthimi dhe kufij më të lartë kredie krahasuar me kreditë konsumatore pa garanci. Shembuj të kredive konsumatore me kolateral janë: Kredi për rregullim dyqani, kredi konsumatore, kredi me peng, depozite/ Titulli Qeveritar, kredi për automjete.

Karta krediti

Ofron një linjë krediti rrotulluese që u mundëson përdoruesve të bëjnë blerje me kredi dhe ta shlyejnë më vonë. Interesi aplikohet nëse shuma nuk paguhet brenda afatit të caktuar.

Kredi biznesi / komerciale

Kreditë e bizneseve u përshtaten bizneseve për të financuar operacionet, për të menaxhuar flukset monetare, për të blerë pajisje ose për t'u zgjeruar. Këto kredi zakonisht kërkojnë dokumentacion financiar, plan biznesi dhe shpesh sigurohen me kolateral, ndërsa kushtet përcaktohen sipas madhësisë, performancës dhe potencialit të biznesit.

Produkte dhe shërbime të tjera

Bankat shpesh ofrojnë një gamë më të gjerë shërbimesh financiare.

Kartat debiti (Debit Cards) - Karta pagese të lidhura drejtpërdrejt me llogarinë rrjedhëse, që mundësojnë transaksione pa para cash dhe tërheqje në ATM.

Produktet e investimit - Produkte financiare që u mundësojnë individëve apo bizneseve të rrisin vlerën e kursimeve të tyre përmes investimeve në tregjet financiare. Ato ofrohen nga bankat, shoqëritë e administrimit të fondeve ose institucione të tjera financiare dhe kanë për qëllim krijimin e fitimit në afat mesatar ose afatgjatë.

Sigurime - Shpërndarja e politikave të sigurimit nga palë të treta, përfshirë sigurimin e jetës, shtëpisë dhe automjetit.

6.3 Kartat e kreditit dhe debitit

Një **kartë krediti** është një shërbim kredie që ofrohet nga një bankë ose ofrues i kartave të kreditit. Ajo vjen me një limit krediti të miratuar paraprakisht bazuar në kredibilitetin tënd financiar. Kjo të lejon të blesh sende, të kryesh transaksione online, dhe të shlyesh shumën me interes çdo muaj brenda ciklit të maturimit.

Një **kartë debiti** është një kartë pagese e lidhur direkt me llogarinë bankare, që të lejon të shpenzosh paratë e tua për blerje online, në dyqane dhe në ATM si dhe të kryesh derdhje në llogarinë bankare nëpërmjet ATM-së. Kur përdor një kartë debiti, fondet zbriten menjëherë nga llogaria, që do të thotë se mund të shpenzohen vetëm paratë që tashmë gjenden në atë llogari.

Si funksionon një kartë krediti

Burimi i fondeve - Një linjë krediti e ofruar nga lëshuesi i kartës (paratë e bankës).

Shlyerja - Merr një pasqyrë mujore dhe mund të zgjedhësh të paguash të gjithë bilancin për të shmangur interesin ose të bësh pagesën minimale dhe të mbash pjesën tjetër të bilancit, mbi të cilën do të ngarkohet interesi.

Borxhi - Lejon të mbash borxh nëse nuk paguan bilancin e plotë çdo muaj, gjë që mund të bëhet e shtrenjtë për shkak të normave të larta të interesit.

Tarifat/Interesi - Mund të ketë tarifa vjetore, tarifa për vonesë në pagesë, dhe interes (APR - Norma vjetore e përqindjes). Zakonisht ofrohet një periudhë pa interes (grace period) nëse bilanci i plotë paguhet në kohë çdo muaj.

Ndërtimi i historikut kreditor - Përdorimi i përgjegjshëm (pagesa në kohë dhe mbajtja e bilanceve të ulëta) ndihmon në krijimin e një historiku kreditor pozitiv, i rëndësishëm për kredi të ardhshme si hipotekat.

Mbrojtja kundër mashtrimeve - Zakonisht ofron mbrojtje më të fortë për konsumatorët kundër mashtrimeve; shumë lëshues kanë politika zero përgjegjësi. Blerjet e sendeve të shtrenjta shpesh përfshihen me mbrojtje shtesë sipas ligjeve të konsumatorit.

Si funksionon një kartë debiti

Blerjet - Kur e përdor kartën për të blerë (swipe-kalimi i kartës përmes lexuesit të shiritit magnetik të kartës për të përpunuar pagesën), tap-përdorimi i teknologjisë contactless), ose duke futur të dhënat online), paratë merren direkt nga llogaria jote bankare.

Tërheqjet në ATM - Mund të përdorësh kartën në një ATM për të tërhequr para cash direkt nga llogaria rrjedhëse ose e kursimit.

PIN dhe siguria - Transaksionet në dyqane ose ATM kërkojnë Numrin Personal të Identifikimit (PIN), dhe mund të kryhen pagesa pa kontakt për shuma të caktuara pa PIN.

Llogaria e lidhur - është e lidhur me llogarinë bankare të individit, kështu që gjendja në kartë është e njëjtë me gjendjen e llogarisë.

Pa huazim - Ndryshe nga karta krediti, këtu nuk merren para borxh. Paratë vijnë direkt nga fondet e individit, kështu që nuk mund të shpenzohet më shumë se çfarë ka në llogari.

Dallimet kryesore nga një kartë krediti

- Burimi i fondeve: Kartat e debitit përdorin paratë e tua nga llogaria bankare, ndërsa kartat e kreditit lejojnë të huazosh para nga banka, të cilat duhet t'i kthehesh më vonë.

- Interesi: Kartat e kreditit mund të ngarkojnë interes nëse bilanci nuk shlyhet i plotë çdo muaj, ndërsa kartat e debitit nuk kanë interesa, sepse nuk po huazon para.

6.4 Hapat për pajisjen e klientit me kartë e debiti ose krediti

Kartat bankare, duke përfshirë kartat e debitit dhe të kreditit, janë mjetet kryesore elektronike të pagesave që lehtësojnë menaxhimin e financave personale dhe të biznesit. Ato ofrojnë akses të shpejtë dhe të sigurt në paratë e llogarive bankare, mundësojnë kryerjen e blerjeve në dyqane, online dhe tërheqjet në ATM, dhe ofrojnë opsione fleksibël financiare, si përdorimi i fondeve ekzistuese me kartën e debitit ose huazimi i fondeve me kartën e kreditit. Këto produkte janë pjesë e rëndësishme e shërbimeve moderne bankare, duke lidhur klientët me mundësi të ndryshme financiare dhe shërbime digjitale.

Hapat për pajisjen e klientit me kartën e debitit

1. Hapja e llogarisë bankare: Klienti duhet të ketë një *llogari rrjedhëse* të hapur në bankë. Sigurohen dokumentet e identifikimit (letërnjoftim, pasaportë, etj.) dhe të dhënat personale.
2. Aplikimi për kartë debiti: Plotësohet një *formular aplikimi* në degë ose online. Banka verifikon të dhënat dhe lidh kartën me llogarinë ekzistuese të klientit.
3. Lëshimi i kartës: Kartës i caktohet *PIN personal* dhe mund të dorëzohet fizikisht në degë ose të dërgohet me postë.
4. Aktivizimi i kartës: Klienti aktivizon kartën përmes ATM, online, ose telefonikisht.
5. Përdorimi i kartës: Përdoret për *blerje, ATM, dhe transaksione online*, ku fondet zbriten menjëherë nga llogaria.

Hapat për pajisjen e klientit me kartën e kreditit

1. Aplikimi për kartë krediti: Klienti plotëson një *formular aplikimi*, në degë ose online. Duhet të sigurohen dokumente mbi *të ardhurat, punësimin dhe identitetin*.
2. Verifikimi i kredibilitetit: Banka ose institucioni lëshues *kontrollon historikun kreditor* të klientit dhe vlerëson aftësinë e tij për shlyerjen e borxhit.
3. Vendosja e limitit të kartës: Bazuar në vlerësimin financiar, banka cakton një *limit krediti të paracaktuar*.
4. Lëshimi i kartës: Klienti merr kartën fizike dhe një *PIN personal*. Mund të ketë shërbime të tjera shtesë si akses online dhe aplikacione për menaxhimin e kartës.
5. Aktivizimi i kartës: Aktivizohet përmes *telefonit, ATM ose online*.

6. Përdorimi i kartës: Lejon të bëhen *blerje, pagesa online dhe tërheqje cash*, me mundësinë e mbajtjes së bilancit dhe pagesës me vonesë (duke paguar interesin për shumën e mbetur).

6.5 Operacionet bankare në varësi të funksionalitetit të tyre

Operacionet bankare mund të kategorizohen sipas funksionalitetit të tyre bazë në tre grupe kryesore: ***shërbime depozitimi dhe kredidhënie, shërbime pagese dhe transferimi***, si dhe ***shërbime ndihmëse ose shtesë***.

Këto operacione janë gjithnjë e më të disponueshme si përmes degëve tradicionale, ashtu edhe përmes platformave online, ku bankingu digjital ofron akses dhe komoditet 24 orë në ditë, 7 ditë në javë.

1. Shërbimet e depozitave dhe të kredidhënies

Ky funksion bazë përfshin menaxhimin e qarkullimit të parave përmes pranimi të depozitave dhe dhënies së kredive. Bankat përfitojnë nga diferenca midis interesit që aplikojnë për kreditë dhe atij që paguajnë për depozitat.

Në degët bankare, ***pranimi i depozitave*** kryhet përmes hapjes së llogarive rrjedhëse, të kursimit ose depozitave afatgjata, si dhe përmes depozitimit të parave cash ose me çek në sportel apo në ATM. Ndërkohë, ***online*** apo përmes celularit, klientët mund të hapin llogari në mënyrë elektronike, të depozitojnë çeqe përmes fotos dhe të krijojnë depozita periodike automatike.

Përsa i përket ***dhënies së kredive ose huave***, në degë klientët aplikojnë për kredi personale, hipotekare apo linja krediti në bashkëpunim me nëpunësit e bankës, duke diskutuar kushtet dhe nënshkruar dokumentet përkatëse. Ndërsa në ***kanalet digjitale***, procesi bëhet më i thjeshtë: mundësohet aplikimi dhe miratimi online i kredive, menaxhimi i kredive ekzistuese dhe planeve të shlyerjes, si dhe aplikimi për karta krediti.

Në lidhje me ***menaxhimin e llogarisë***, në degë, klientët mund të informohen për gjendjen e llogarisë, të përditësojnë të dhënat personale, të porosisin karta të reja ose të zgjidhin probleme përmes sportelit.

2. Shërbimet e pagesave dhe transferimeve

Këto operacione mundësojnë lëvizjen e parave midis llogarive dhe institucioneve, brenda vendit dhe ndërkombëtarisht.

Në degët bankare, ***transferimet e fondeve*** realizohen duke iniciuar transfertat bankare ose duke bërë kërkesa për urdhëra pagese drejtpërdrejt në sportel. Ndërsa ***në mënyrë elektronike***, klientët mund të kryejnë transfertat në kohë reale midis llogarive të tyre ose llogarive të tjera, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, si dhe të krijojnë urdhëra të përhershëm apo debitime direkte për pagesa automatike.

Përsa i përket **pagesave të faturave**, në degë ato kryhen përmes pagesave me para cash ose me çek në sportel, dhe klienti mund të vendosë pagesa periodike me ndihmën e përfaqësuesit të bankës. Ndërkohë, në **platformat online ose aplikacionin celular**, pagesat mund të bëhen në mënyrë të pavarur, qoftë si pagesa të vetme apo periodike, për shërbime të ndryshme si energjia elektrike, telefoni apo furnitorë të tjerë.

Në lidhje me **instrumentet monetare**, në degë klientët mund të tërheqin ose të depozitojnë çeqe, të trajtojnë kambiale apo të blejnë valutë të huaj. Përmes kanaleve **online**, këto veprime thjeshtohen duke ofruar mundësi për shkëmbim valutor elektronik dhe aplikime për urdhëra pagese që dërgohen me postë.

3. Shërbimet ndihmëse dhe shtesë

Në degët bankare, **ruajtja e sigurt** ofrohet përmes marrjes me qira të kasafortave, ku klientët mund të depozitojnë sende me vlerë dhe dokumente të rëndësishme. Ky shërbim nuk aplikohet në formatet **online**, pasi ruajtja fizike e sendeve kërkon praninë fizike në degë.

Sa i përket **shërbimeve të investimeve**, klientët në degë mund të konsultohen drejtpërdrejt me këshilltarë financiarë për menaxhimin e pasurisë, investimin në fonde apo tregtimin e letrave me vlerë. Ndërkohë, nëpërmjet **platformave digjitale**, banka u mundëson klientëve akses në platforma tregtare online, informacion mbi investimet dhe mjete për menaxhimin e portofolit personal.

Në aspektin e **shërbimit ndaj klientit**, në degë ofrohet ndihmë ballë për ballë për çështje të ndërlikuara, ankesa apo shërbime të specializuara që kërkojnë ndërhyrje njerëzore. Ndërsa **online**, klientët mund të marrin ndihmë të menjëhershme përmes chatbotëve me inteligjencë artificiale, mesazheve të sigurta ose video-thirrjeve, si edhe të kenë akses të menjëhershëm në seksionin e pyetjeve të shpeshta.

Tema 7: Sistemet e pagesave bankare

7.1 Hyrje në sistemin e pagesave

Siguria, qëndrueshmëria dhe efikasiteti i sistemeve të pagesave janë elemente parësore për funksionimin e rregullt të sistemit financiar. **Sistemi i pagesave është një bashkësi instrumentesh, procedurash dhe rregullash për transferimin e fondeve midis pjesëmarrësve dhe operatorit të sistemit. Sistemet e pagesave janë kanalet nëpërmjet të cilave bëhet transferimi i fondeve ndërmjet bankave, si dhe janë një nga rrugët kryesore nëpërmjet të cilave krizat financiare mund të transmetohen në sistemet dhe tregjet kombëtare dhe ato ndërkombëtare. Sisteme pagesash të sigurta dhe të qëndrueshme janë kërkesat kryesore për nxitjen dhe ruajtjen e stabilitetit financiar.**

Transferimi i fondeve kryhet nëpërmjet një infrastrukture teknike të posaçme. Duke pasur parasysh se sistemet e pagesave fuqishëm ndikojnë në shpejtësinë e lëvizjes së fondeve në ekonomi, shpenzimet e përgjithshme dhe likuiditetin e pjesëmarrësve, dhe se ato shërbejnë si një kanal transmetimi i politikës monetare, bëhet fare e qartë arsyeja e interesimit të Bankës Qëndrore për sigurimin e funksionimit efikas të saj.

7.2 Legjislacioni për sistemet e pagesave

Banka e Shqipërisë, në mbështetje të objektivit të saj kryesor, arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, ka përgjegjësinë ligjore "të nxisë dhe të mbështesë funksionimin normal të sistemeve të pagesave". Kjo përgjegjësi përcaktohet në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar. Gjithashtu, ky ligj, i jep të drejtën bankave dhe degëve të bankave të huaja të marrin pjesë në sisteme elektronike të pagesave, si dhe përcakton se veprimtaria dhe pjesëmarrja e këtyre sistemeve është kompetencë e Bankës së Shqipërisë.

Ligjet që rregullojnë veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë dhe sistemin e pagesave përcaktojnë rolin qendror të Bankës në sigurimin e stabilitetit financiar dhe funksionimin e rregullt të tregut financiar. Banka e Shqipërisë ka detyrë të zhvillojë dhe mbikëqyrë sistemin e pagesave, të përcaktojë rregullat për kryerjen e pagesave dhe të garantojë sigurinë dhe eficiencën e instrumenteve të përdorura. Ligji për bankat lejon pjesëmarrjen e bankave dhe degëve të huaja në sistemet elektronike të pagesave, të rregulluara nga aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë. Ndërkohë, ligji **"Për sistemin e pagesave"** i jep Bankës kompetenca për liçencimin, mbikëqyrjen dhe inspektimin e operatorëve e pjesëmarrësve, duke siguruar transparencë dhe funksionim të qëndrueshëm. Ligji **"Për shërbimet e pagesave"** mundëson që bankat dhe institucionet e tjera të liçencuara të ofrojnë shërbime moderne pagesash dhe të marrin pjesë në sistemet kombëtare, në kushte të barabarta dhe pa diskriminim, nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë. Ky ligj përforcon konkurrencën dhe siguron që qytetarët e bizneset të kenë akses në shërbime pagesash të sigurta dhe efikase.

Ligji **"Për Bankën e Shqipërisë"**, i ndryshuar ka rëndësi themelore, pasi përcakton rolin e kësaj banke si autoriteti qendror monetar të vendit. Ai i jep Bankës së Shqipërisë përgjegjësinë për të ruajtur stabilitetin monetar dhe financiar, për të zhvilluar tregun financiar të brendshëm dhe për të garantuar funksionimin normal të sistemit të pagesave. Ky ligj e vendos Bankën e Shqipërisë në qendër të politikave monetare dhe të mbikëqyrjes së proceseve që lidhen me qarkullimin e parasë dhe pagesat ndërbankare.

Ligji **"Për bankat në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar ka rëndësi sepse rregullon mënyrën se si bankat dhe degët e bankave të huaja marrin pjesë në sistemet elektronike të pagesave. Ai përcakton marrëdhëniet ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe institucioneve bankare, duke siguruar që veprimtaria e pagesave të zhvillohet në përputhje me standardet ligjore dhe të mbikëqyret përmes akteve nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë.

Ky ligj përforcon konkurrencën dhe siguron që qytetarët e bizneset të kenë akses në shërbime pagesash të sigurta dhe efikase.

7.3 Rolet kryesore të Bankës së Shqipërisë në sistemin e pagesave

Banka e Shqipërisë luan rol kyç në nxitjen e funksionimit normal të sistemit të pagesave, duke promovuar sigurinë dhe efikasitetin. Për arritjen e objektivit, Banka e Shqipërisë vepron si operator, mbikëqyrës dhe katalizator e reformator.

Roli operacional - Ofron infrastrukturën për kleringun dhe shlyerjen e pagesave ndërbankare; administron dhe operon një sistem hibrid për klering dhe shlyerje të pagesave me vlera të mëdha dhe të vogla.

Roli mbikëqyrës - Përcakton rregullat dhe procedurat, vendos standardet për të nxitur dhe mbështetur një sistem pagesash të sigurta, efikas për procesimin e pagesave dhe vlerëson sistemet kundrejt standardeve të vendosura.

Roli i katalizatorit - Roli i BSH-së si katalizator nxit dhe promovon efikasitetin dhe sigurinë në përdorimin e instrumenteve të pagesave dhe të sistemeve të pagesave.

7.4 Banka e Shqipërisë si operator i sistemeve të pagesave

Në rolin e operatorit, Banka e Shqipërisë ofron shërbimet e shlyerjes dhe të klerimit nëpërmjet sistemeve:

Sistemi ndërbankar i pagesave me vlerë të madhe – AIPS

AIPS (Albanian Interbank Payment System) është sistemi i shlyerjes bruto, në kohë reale të urdhërpagesave, në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar. Në të procesohen të gjitha pagesat ndërbankare me vlerë të madhe, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në monedhën kombëtare Lekë. Në AIPS marrin pjesë Banka e Shqipërisë dhe të gjitha bankat tregtare si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë, si edhe Ministria e Financave si pjesëmarrës i tërthortë. Gjithashtu, në këtë sistem shlyejnë pozicionet e tyre edhe sistemi AECH, sistemi AFISaR dhe skemat e kartave.

Sistemi për shlyerjen e transfertave vendase në euro për klientë - AIPS EURO

AIPS (Albanian Interbank Payment System) EURO është sistemi i shlyerjes bruto, në kohë reale për urdhërpagesat e klientëve të pjesëmarrësve në sistem për pagesat në euro brenda vendit. Në të procesohen të gjitha pagesat ndërbankare për klientët, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në monedhën EURO. Në AECH marrin pjesë Banka e Shqipërisë dhe të gjitha bankat tregtare si pjesëmarrës.

Sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH

Banka e Shqipërisë ofron shërbimin e kleringut prej vitit 1997. Nëpërmjet këtij shërbimi ofrohet klerimi i çeqeve dhe i urdhërpagesave ndërbankare të iniciuara nga klientët.

AECH (Albanian Electronic Clearing House) është sistem i automatizuar i klerimit të pagesave me vlerë të vogël për vlera deri në 10 milionë lekë. Ky sistem është në përputhje me SEPA (zona e vetme e pagesave në Euro) dhe klerimi i instrumenteve të pagesave kryhet në seanca klerimi. Rezultatet shumëpalëshe neto shlyhen në fund të çdo seance në sistemin AIPS. Sistemi AECH është plotësisht i integruar me sistemin AIPS për qëllime të shlyerjes automatike në të. Në AECH marrin pjesë Banka e Shqipërisë dhe të gjitha bankat tregtare si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë, si edhe Ministria e Financave si pjesëmarrës i tërthortë.

Si dhe, të tregtimit të titujve, nëpërmjet sistemit:

Sistemi i shlyerjes dhe regjistrimit të titujve - AFISaR

AFISaR (Albanian Financial Instrument Settlement and Registration) është sistemi qendror i shlyerjes dhe regjistrimit të titujve shtetërorë, për të cilët Banka e Shqipërisë organizon ankandet në zbatim të Marrëveshjes me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Sistemi AFISaR është plotësisht i pajtueshëm me parimet e Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (BIS) për shlyerjen e transaksioneve me tituj në përputhje me parimin “dorëzim kundrejt pagesës” (DvP – Delivery versus Payment)

Pjesëmarrësit në AFISaR ndahen në dy kategori:

- Pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë – Kanë llogari titujsh drejtpërdrejt në AFISaR, të cilën e operojnë vetë duke aksesuar sistemin AFISaR
- Pjesëmarrësit e tërthortë – Hapin llogari titujsh nëpërmjet pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë.

Banka e Shqipërisë ofron lehtësira për shlyerjen neto (manualisht të procesuara në sistem) të pagesave të iniciuara me çeqe, si dhe të pagesave me karta VISA dhe MasterCard, të iniciuara dhe të shlyera në monedhën kombëtare, si edhe shlyerjen në sistemin AIPS të pjesës cash të transaksioneve me titujt e Qeverisë (bono dhe obligacione të Qeverisë në monedhën kombëtare - Lekë), të cilat gjenerohen nëpërmjet sistemit AFISaR.

Duke marrë në konsideratë unikalitetin e këtyre sistemeve në tregun shqiptar, Banka e Shqipërisë kontribuon në mënyrë të qenësishme në funksionimin normal të ekonomisë, stabilitetit financiar, si dhe në efikasitetin dhe integrimin e tregjeve.

7.5 Transformimi në sistemin e pagesave në Shqipëri

Sistemet e pagesave bankare kanë hyrë në një fazë të re zhvillimi, të quajtur shpesh “**Revolucioni i Pagesave**”, i cili po transformon mënyrën se si individët dhe bizneset kryejnë transaksionet e tyre financiare. Ky ndryshim lidhet ngushtë me digjitalizimin, inovacionin teknologjik dhe integrimin e standardeve evropiane në tregun shqiptar të shërbimeve financiare.

Në të kaluarën, pagesat bankare ishin të ngadalta dhe të kufizuara kryesisht në forma tradicionale si transfertat në sportel apo përdorimi i parasë fizike. Sot, falë ligjit të ri “Për shërbimet e pagesave” (nr. 55/2020) dhe përafrimit me direktivën evropiane PSD2 (Payment Services Directive 2), sistemi i pagesave në Shqipëri është bërë më i hapur dhe më konkurrues. Ky ligj ka lejuar hyrjen e aktorëve të rinj, si institucionet e pagesave dhe fintech-et, të cilat ofrojnë shërbime moderne, të shpejta dhe me kosto më të ulët për përdoruesit.

Bankat tashmë nuk janë të vetmet që përpunojnë pagesa, por mbeten qendra e sigurisë dhe stabilitetit të sistemit financiar. Ato po investojnë në *infrastruktura digjitale, aplikacione mobile, dhe platforma online banking* për të ofruar shërbime më të shpejta dhe më të përshtatura ndaj nevojave të klientëve. Nga ana tjetër, klientët po përfitojnë nga rritja e përfshirjes financiare, pasi edhe zonat më të largëta kanë mundësi të kryejnë pagesa elektronike, të bëjnë transfertat dhe të menaxhojnë financat pa qenë e nevojshme prania fizike në bankë.

Ky proces po çon drejt *zvogëlimit të përdorimit të parasë fizike*, duke rritur transparencën dhe sigurinë e transaksioneve. Pagesat digjitale, kartat bankare, portofolat elektronikë dhe transferat në kohë reale po bëhen pjesë e përditshme e jetës ekonomike.

Sistemet e pagesave bankare po evoluojnë nga një model tradicional drejt një ekosistemi modern, të integruar dhe të digjitalizuar. Ky revolucion jo vetëm që po përmirëson efikasitetin e sistemit financiar, por edhe po ndryshon kulturën e përdorimit të parave në Shqipëri, duke e bërë atë më të sigurt, më të shpejtë dhe më të aksesueshme për të gjithë.

Tema 8: Shërbimet e pagesave dhe të transfertave të parave

8.1 Klasifikimi i transfertave bankare. Sipas drejtimit dhe destinacionit të transfertës


Mënyra e realizimit të pagesave dhe transfertave përfshin procesin se si klienti dërgon ose merr fonde, qoftë nëpërmjet degës, kanaleve elektronike apo operatorëve të pagesave, duke siguruar që transaksioni të kryhet saktë, shpejt dhe me të gjitha të dhënat e nevojshme. Transfertat sipas drejtimit dhe destinacionit klasifikohen si më poshtë:

Sipas drejtimit të transfertës

1. Transferta në nisje (Outgoing payments)

Transferta në nisje janë pagesat që klienti dërgon drejt një përfituesi tjetër, brenda ose jashtë vendit, duke lëvizur fondet nga llogaria e tij drejt destinacionit të zgjedhur.

Diagrama:




Hapat për kryerjen e një transferte në nisje:

1. Klienti nis urdhërpagesën nga aplikacioni mobile, online banking ose nga sporteli.
2. Banka e dërguesit kryen verifikimet bazë: fonde, IBAN, qëllimi, kufizimet ligjore.
3. Nëse të dhënat janë të sakta, transaksioni pranohet; në të kundërt refuzohet.
4. Pagesa dërgohet në sistemin ndërbankar të klering-ut.
5. Banka e përfituesit merr urdhërin dhe krediton llogarinë përkatëse.
6. Klienti merr njoftimin për kryerjen e transfertës.

2. Transferta në mbërritje (Incoming payments)

Transferta në mbërritje janë fondet që i vijnë klientit nga një bankë tjetër brenda ose jashtë vendit dhe kreditohen në llogarinë e tij. Diagrama:



```

      |
      v
+-----+-----+
| Klienti njoftohet për      |
| pagesën e mbërritur        |
+-----+-----+

```

Hapat për kryerjen e një transferte në mbërritje:

1. Banka e dërguesit nis pagesën drejt përfituesit.
2. Pagesa kalon në sistemin ndërbankar të klering-ut.
3. Banka e përfituesit merr njoftimin për transaksionin.
4. Bëhen kontrollet standarde: identiteti i përfituesit, saktësia e IBAN, rregullat ligjore, filtrat e riskut.
5. Nëse gjithçka është e rregullt, llogaria e përfituesit kreditohet.
6. Në të kundërt, pagesa refuzohet dhe kthehet te banka e dërguesit.
7. Klienti përfitues njoftohet për ardhjen e fondeve.

Sipas destinacionit

1. Transferta brenda vendit (Domestic transfers)

Transfertat që kryhen brenda territorit të Shqipërisë, në lekë ose në valutë, drejt llogarive të bankave shqiptare.

2. Transferta ndërkombëtare (International transfers)

Transfertat që kryhen drejt bankave jashtë Shqipërisë ose që vijnë nga jashtë vendit, nëpërmjet sistemeve ndërkombëtare të pagesave (kodi SWIFT). Hapat për regjistrimin e një transferte në nisje jashtë Shqipërisë janë si më poshtë:

- Emri dhe adresa e plotë të përfituesit;
- IBAN i llogarisë së përfituesit ose numri i llogarisë për ato vende ku nuk aplikohet IBAN;
- Emri dhe adresa e bankës së përfituesit;
- BIC/Sëift code i bankës përfituese. Në mungesë të BIC/Sëift Code janë të vlefshëm kode si: Routing Number, sort-code etj.
- Qëllimi i transfertës
- Përzgjedhja e komisioneve: **OUR** (Të gjitha komisionet do të paguhet nga klienti urdhërues), **SH.A** (Komisionet e bankës urdhëruese paguhet nga klienti urdhërues ndërkohë që komisionet e aplikuara nga bankat e tjera paguhet nga klienti përfitues), **BEN** (Të gjitha komisionet do të paguhet nga klienti përfitues)

8.2 Klasifikimi i transfertave bankare. Sipas marrëdhënies midis dërguesit dhe përfituesit.

Sipas kanalit të përdorur

Sipas marrëdhënies midis dërguesit dhe përfituesit

1. Transferta mes llogarive të mia

Transferte mes llogarive të mia është lëvizja e fondeve nga një llogari bankare e hapur nga i njëjti individ tek një tjetër llogari e tij në të njëjtën bankë ose në banka të ndryshme.


- Këto transferta nuk përfshijnë palë të tjera (nuk ka përfitues të jashtëm).
- Synimi kryesor është menaxhimi i parave personale dhe organizimi i fondeve.

Përfitimet e transferteve mes llogarive personale

1. Menaxhim i lehtë i mjeteve personale.
2. Kursim i fondeve pa lëvizje fizike të parave.
3. Organizim i pagesave të rregullta (faturat, qeratë, kredia).
4. Reduktim i gabimeve dhe vonesave në pagesa.
5. Siguri më e madhe krahasuar me paratë cash.

2. Transferta brenda së njëjtës bankë (In-bank transfer)

Dërgim fondesh nga një klient te një klient tjetër brenda të njëjtës bankë. Diagrama:



3. Transferta ndërbankare brenda vendit

Transferrat ndërbankare brenda vendit janë lëvizje fondesh nga një llogari tek një tjetër në banka të ndryshme brenda të njëjtit vend. Ekzekutohet përmes sistemit kombëtar të pagesave të Bankës së Shqipërisë.

Sipas kanalit të përdorur

Në degë (Branch transfers) - Transferrat e ekzekutuara fizikisht në sportel, me asistencën e punonjësit të bankës.

Online (Internet Banking) - Transferrat e kryera përmes platformës online të bankës.

Nëpërmjet aplikacionit mobile (Mobile Banking) - Transferrat kryhen përmes aplikacionit celular të bankës.

8.3 Klasifikimi i transfertave bankare. Sipas monedhës dhe komisioneve

Sipas monedhës

1. Transferta në monedhë vendase (ALL)

Brenda vendit, zakonisht më të shpejta dhe me komisione më të ulëta.

2. Transferta në valutë

Brenda ose jashtë vendit në monedha të huaja (EUR, USD, GBP, CHF, etj.).

Sipas komisioneve (vetëm për transfertat ndërkombëtare)

1. OUR – Dërguesi paguan të gjitha komisionet
Shuma mbërrin e plotë te përfituesi.
2. BEN – Përfituesi paguan të gjitha komisionet
Dërguesi paguan vetëm komisionin e bankës së tij.
3. SHA – Komisionet ndahen
Dërguesi paguan komisionin e bankës së tij, përfituesi të bankës së tij.

8.4 Forma të tjera të transfertave me jashtë: Money Gram dhe UPT

MoneyGram

MoneyGram është një lider botëror në fushën e transfertave dhe mundëson mbërritjen e parave kudo ku paraqitet nevoja, si në të gjithë botën ashtu edhe brenda të njëjtit vend.

MoneyGram është lider i të gjitha shërbimeve të transfertave dhe operon në bashkëpunim të ngushtë me punonjës të zgjedhur në më tepër se 200.000 degë në 190 shtete. Sistemi i Pagesave MoneyGram është një emër i rëndësishëm në fushën e transfertave të parave. Me anë të rrjetit ndërkombëtar të transfertave të MoneyGram klientët mund të dërgojnë dhe të marrin para me shpejtësi (zakonisht brenda 10 minutash) dhe me çmime tepër të favorshme dhe konkurruese.

Karakteristikat e MoneyGram:

I shpejtë - Paratë mund të tërhiqen brenda rreth 10 minutash nga dërgimi.

I leverdisshëm - Me mbi 200.000 pika shërbimi, klientët kanë gjithmonë një degë MoneyGram afër.

I përshtatshëm - Nuk kërkohet llogari bankare apo kartë krediti për të dërguar ose marrë para.

Personal - Dërguesi mund të shoqërojë transfertën me një mesazh deri në 10 fjalë.

UPT – Universal Payment Transfer

UPT e ka filluar aktivitetin e saj në Turqi si pjesë e Grupit Calik Holding nëpërmjet Bankës më të madhe të Investimeve - Aktif Bank me brandin UPT – Transferta të Lira Parash.

Brenda një periudhe të shkurtër kohore, UPT arriti të operojë me rreth 400.000 zyra pagesash që vazhdojnë të zgjerohen në të pesë kontinentet. Ky rrjet kaq i gjerë e ka transformuar UPT në një sistem të preferuar për transfertat brenda dhe jashtë vendit.

Sot, miliona njerëz përdorin shërbimin e UPT-së për transfertat e parave në të gjithë globin. UPT ka një infrastrukturë teknike të avancuar dhe fokusohet në kënaqësinë e klientit dhe orientimin e shërbimit ndaj klientit që e diferencon atë nga sistemet e tjera të transfertave të parave.

Universal Payment Transfer (UPT) përfaqëson një model të standardizuar dhe të automatizuar të përpunimit të pagesave, i krijuar për të siguruar një qarkullim të sigurt, të shpejtë dhe efikas të

fondeve midis institucioneve financiare. Ai është rezultat i zhvillimit të sistemeve moderne të pagesave, të cilat synojnë të integrojnë të gjitha llojet e transfertave – kombëtare dhe ndërkombëtare – brenda një platforme të vetme teknologjike.

8.5 Sistemi elektronik i transferimit të fondeve

Një sistem elektronik i transferimit të parave u mundëson individëve dhe bizneseve të dërgojnë para në mënyrë digjitale. Këto sisteme kanë revolucionarizuar mënyrën se si i trajtojmë transaksionet financiare, duke ofruar metoda më të shpejta, të sigurta dhe më të përshtatshme sesa transfertat tradicionale bankare. Ky artikull do të shqyrtojë lloje të ndryshme të sistemet elektronike të transferimit dhe të nxjerrin në pah përfitimet e tyre.

Ekzistojnë disa lloje të sistemeve elektronike të transferimit të parave, duke përfshirë ***transfertat bankare, aplikacionet e parave celulare dhe sistemet e pagesave nga kolegët***. Transfertat bankare përdoren zakonisht për transaksione të mëdha ndërkombëtare, ndërsa aplikacionet celulare si Venmo dhe PayPal janë të njohura për pagesat e përditshme. Sistemet "peer-to-peer" i lejojnë individët të dërgojnë para drejtpërdrejt tek njëri-tjetri me tarifa minimale.

Transfertat elektronike funksionojnë duke lëvizur fondet midis institucioneve ose llogarive të ndryshme financiare. Në varësi të sistemit, transferimi mund të përfundojë brenda disa minutash ose merr disa punë ditë. Në përgjithësi, dërguesi e fillon transferimin duke dhënë të dhënat e marrësit dhe paratë tërhiqen elektronikisht nga llogaria e dërguesit dhe depozitohen në llogarinë e marrësit.

Sistemet elektronike të transferimit të parave ofrojnë shpejtësi, komoditet dhe siguri më të lartë krahasuar me metodat tradicionale. Ato lejojnë dërgimin e fondeve nga kudo dhe në çdo kohë, megjithëse shpesh shoqërohen me tarifa që ndryshojnë sipas llojit të shërbimit. Siguria mbetet një element i rëndësishëm, ndaj përdoruesit duhet të zgjedhin platforma të besueshme dhe të mbrojnë të dhënat e tyre. Transfertat celulare dhe ato ndërkombëtare e thjeshtojnë ndjeshëm dërgimin e parave, si për individët ashtu edhe për bizneset. Zgjedhja e sistemit më të përshtatshëm varet nga nevojat për shpejtësi, kosto, siguri dhe praktikitet.

Tema 9: Shërbimet e ofruara përmes kanaleve digjitale të bankave

9.1 Rëndësia e shërbimet e ofruara përmes kanaleve digjitale të bankave

Në ditët e sotme njerëzit për të kryer shërbime të ndryshme përdorin telefonin dhe aksesimi në internet është në rritje të vazhdueshme. Këto zhvillime janë të rëndësishme pasi vlerësojnë orientimin e individëve ndaj metodave të reja për të realizuar më shumë procese. Individët po përdorin aksesimin në internet për të realizuar një sërë aktiviteteve, si blerjet e produkteve online, shkarkimi i dokumentave, kryerja e pagesave duke u lidhur me llogarinë bankare, etj.

Zhvillimet në teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, veçanërisht në rritjen e nivelit të përdorimit të internetit, ka një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e sistemit bankar. Bankat duhet të analizojnë ecurinë e sjelljes së individëve në treg dhe të identifikojnë strategjitë e duhura për arritjen e më shumë klientëve duke plotësuar nevojat e tyre. Krijimi i mundësisë për të përdorur llogarinë bankare me anë të hyrjes në internet, nëpërmjet kompjuterit apo telefonit, përbën një zhvillim të sektorit bankar, duke ndryshuar nga modeli tradicional. Roli i teknologjisë në zhvillimin e sektorit bankar është i rëndësishëm. Zhvillimet e fundit në teknologjinë e komunikimit kanë mundësuar krijimin e metodave të reja të mënyrës së realimit të shërbimeve bankare, të fokusuara në përdorimin e internetit në të cilën klientët mund të aksesojnë llogarinë e tyre në telefon apo kompjuter. Pra, “mobile banking” është një shërbim i ofruara nga bankat që lejon klientët e saj të marrin informacione për llogarinë e tyre nëpërmjet programeve përkatëse në telefon.

Teknologjia e komunikimit dhe e informacionit tashmë njihet si një teknologji vetëshërbimi, e cila lejon përdoruesit e saj të ndërveprojnë në mënyrë elektronike pa patur nevojën e shërbimeve apo ndihmës nga të tjerët. Në fushën e shërbimeve bankare, këto shërbime përfshijnë: *bankomatët (ATM), mobile banking, internet banking, sistemin e pagesave elektronike*. Në tërësi, shërbimet bankare të përfshira në fushën e teknologjisë së re janë të quajtura sistemi i informacionit bankar. Shërbimet bankare në telefon mund të ndahen në dy kategori:

1. *m-banking (mobile banking)* dhe

2. *m-payments (mobile payments)*.

Shërbimi bankar në telefon apo m-banking është një teknologji e cila lejon përdoruesit të kontrollojnë veprimet financiare duke u lidhur me llogarinë e tyre bankare nëpërmjet telefonit. Ndërkohë, pagesa bankare (m-payments) nënkuptojnë përdorimin e telefonit për të kryer shërbimë të pagesave, në të cilën paratë transferohen të shitësi nëpërmjet një ndërmjetësi.

9.2 E-banking

E-banking është produkt i cili është dizenuar me qëllim të bankimit online, që ju mundëson qasje të lehtë dhe të sigurt në llogarinë tuaj bankare. “E-banking” është shërbim elektronik, i sigurt, i shpejtë, i lehtë dhe efikas, i cili ju mundëson qasje në llogarinë tuaj dhe kryerjen e shërbimeve bankare përmes internetit 24 orë në ditë, 7 ditë në javë.

Ndërkohë, “e-banking” ose shërbimi bankar elektronik i referohet kryerjes së shërbimeve bankare me anë të pajisjeve teknologjike. “E-banking” është një ndërthurje e një tëresi shërbimesh, si: internet banking, m-banking, ATM, sistemi i transferimit të parave, kartat e debitit dhe të kreditit, menaxhimi i marrëdhënieve me klientët (CRM) etj. Zhvillimet në fushën e teknologjisë, të cilat lidhen me rritjen e aksesit të internetit dhe sigurisë së saj, kanë ndikuar në rritjen e përdorimit të shërbimeve bankare online. Këto ndryshime ndikojnë që shërbimet bankare të mund të ofrohen 24 orë.

Me anë të këtij shërbimi kurseni kohën tuaj duke i kryer transaksionet bankare në çdo vend dhe në çdo kohë, nga shtëpia apo zyra juaj, mjafton tw kesh qasje në internet.

9.3 Forma të shërbimeve elektronike bankare

Forma të shërbimeve elektronike bankare:

Internet Banking – “Internet Banking” ndihmon në menaxhimin e shumë transaksioneve bankare online nëpërmjet programeve kompjuterike. “Internet Banking” lejon në trajtimin e shumë transaksione bankare nëpërmjet kompjuterit personal. Për shembull, mund ta përdorim kompjuterin për të parë bilancin e llogarisë, për të kërkuar transferime midis llogarive dhe për të paguar faturat në mënyrë elektronike.

Mobile Banking – “Mobile Banking” është shërbimi që lejon klientët të kryejnë veprime bankare përmes telefonit celular ose tabletit, si kontrolli i bilancit, transferta, pagesa faturash dhe menaxhimi i kartave, duke ofruar qasje të menjëhershme dhe të sigurt në llogari kudo dhe në çdo kohë.

Makina të automatizuara (ATM) - Një makinë automatike (ATM) është një pajisje elektronike telekomunikimi që lejon konsumatorët e një institucioni financiar të përdorin në mënyrë të drejtpërdrejtë një metodë të sigurtë të komunikimit për të hyrë në llogaritë e tyre bankare, për të porositur ose për të bërë tërheqje të parave të gatshme dhe kontrollimin e bilanceve të llogarisë pa nevojën e një ndërveprimi njerëzor. Përkufizohet si një makinë kompjuterike që lejon klientët e bankës të kenë akses në llogaritë e tyre me një kartelë të koduar magnetikisht dhe me një numër kodesh. Ai u mundëson klientëve të kryejnë disa operacione bankare, të tilla si tërheqja e parave të gatshme, depozita, pagesa e faturave, marrja e pasqyrave bankare, transferimi i parave.

SMS Banking – Shërbim bankar elektronik që lejon klientët të marrin njoftime të menjëhershme mbi aktivitetin e llogarisë së tyre, si transaksionet e kryera, bilanci i disponueshëm apo pagesat e bëra. Përveç informacionit, disa banka mundësojnë edhe kryerjen e veprimeve të thjeshta përmes SMS, si transferimi i një shume të vogël ose kontrolli i detajeve të llogarisë. Ky shërbim ofron akses të shpejtë dhe të sigurt, edhe pa përdorimin e internetit, duke e bërë menaxhimin e llogarisë më praktik dhe të lehtë për klientët.

POS (Point of Sale) hyn te format e shërbimeve elektronike bankare, por me një dallim:

- POS është pajisja fizike që lejon kryerjen e pagesave elektronike me kartë (debit, kredit ose karta para-pagese) në dyqane, restorante ose biznese të tjera.
- Ndryshe nga Internet/Mobile Banking, ku klienti menaxhon vetë llogarinë, te POS transaksioni realizohet drejtpërdrejt në vendin e shitjes, por gjithsesi përdor rrjetin elektronik të bankës.

Pra, POS është një kanal i shërbimeve elektronike bankare për pagesa, pjesë e sistemit të e-banking dhe sistemit të pagesave digjitale.

9.4 Shërbimet që ofron e-banking

Aktualisht, interneti konsiderohet si "zemra" e strukturës me shumë kanale, zbatuar nga bankat dhe në përdorim për një numër gjithnjë në rritje llogarish bankare të klientëve. Disa nga shërbimet bazë që ofron e-banking janë:

- Informacion mbi gjendjen e llogarisë;
- Informacion mbi transaksionet e fundit të kryera (pasqyrë e lëvizjeve të llogarisë);
- Kryerje pagesash të domosdoshme (shpenzime telefoni, drita, ujë, sigurime);
- Transferta fondesh ndërmjet llogarive personale;
- Transferime fondesh kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Shlyerje të këstit të kredisë;
- Informim mbi kushtet e punës të bankës;
- Ndryshim i të dhënave personale të klientit.

Ndërsa shërbime më të avancuara (të ofruara vetëm nga disa banka) janë:

- Hapje depozite online;
- Aplikim për kredi.

9.5 Rëndësia e e-banking

Ne do të shohim rëndësinë e bankingut elektronik për bankat, klientët dhe bizneset nw veçanti.

Bankat

- *Kosto më të vogla të transaksionit* - transaksionet elektronike janë më të lira;
- *Një diferencë e reduktuar për gabimin njerëzor* - meqenëse informacioni transmetohet në mënyrë elektronike, nuk ka vend për gabim njerëzor;
- *Sasi më e vogël dokumentacioni fizik* - të dhënat digjitale reduktojnë dokumentet dhe e bëjnë procesin më të lehtë për t'u trajtuar;
- *Klientë më besnikë* - meqë shërbimet e-banking janë të favorshme për konsumatorët, bankat përjetojnë besnikëri më të lartë nga klientët e tyre.

Klientët

- *Komoditet* - një klient mund të hyjë në llogarinë e tij dhe të kryejë transaksione nga kudo 24x7x365;
- *Kosto më e ulët për transaksion* - pasi që konsumatori nuk duhet të vizitojë degën për çdo transaksion, ai kursen kohë dhe para;
- *Nuk ka pengesa gjeografike* - në sistemet bankare tradicionale, distanca gjeografike mund të pengojë disa transaksione bankare. Megjithatë, me e-banking, barrierat gjeografike zvogëlohen.

Bizneset

- *Shqyrtimi i llogarive* - Pronarët e bizneseve dhe anëtarët e caktuar të stafit mund t'i qasen llogarive shpejt duke përdorur një ndërfaqe bankare në internet. Kjo u lejon atyre të rishikojnë aktivitetin e llogarisë dhe gjithashtu të sigurojnë funksionimin e qetë të llogarisë;
- *Produktivitet më të mirë* - Bankingu elektronik përmirëson produktivitetin. Kjo lejon automatizimin e pagesave të rregullta mujore dhe një mori karakteristikash të tjera për të rritur produktivitetin e biznesit;
- *Shpenzime më të ulëta* - Zakonisht, shpenzimet në marrëdhëniet bankare bazohen në burimet e shfrytëzuara. Nëse një biznes i caktuar kërkon më shumë ndihmë me transfertat bankare, depozita dhe të tjera, atëherë banka paguan tarifat më të larta. Me banking online, këto shpenzime minimizohen;
- *Gabime të vogla* - Bankingu elektronik ndihmon në zvogëlimin e gabimeve në transaksionet e rregullta bankare. Shkrimi i keq, informacioni i gabuar, mund të shkaktojë gabime të cilat mund të jenë të kushtueshme. Gjithashtu, shqyrtimi i lehtë i veprimtarisë së llogarisë rrit saktësinë e transaksioneve financiare;
- *Mashtime të reduktuara* - Bankingu elektronik ofron një gjurmë digjitale për të gjithë punonjësit të cilët kanë të drejtë të modifikojnë aktivitetet bankare. Prandaj, biznesi ka një shikueshmëri më të mirë në transaksionet e saj duke e bërë të vështirë për ndonjë mashtues që të shkaktojë dëmtime.

Tema 10: Kredithënia bankare

10.1. Kuptimi dhe rëndësia e kredithënies bankare

Kredithënia bankare është procesi përmes të cilit bankat ofrojnë kredi dhe hua për individë dhe biznese. Ky proces kanalizon paratë nga kursimtarët tek ata që kanë nevojë për financim, nxit rritjen ekonomike përmes blerjeve dhe investimeve dhe ndihmon në krijimin e parasë në ekonomi. Bankat mundësojnë gjithçka, nga blerja e një shtëpie deri tek zgjerimi i aktivitetit të një kompanie, duke vepruar si ndërmjetës i rëndësishëm për kapitalin dhe aktivitetin ekonomik.

Funksionet kryesore të bankave në procesin e kredithënies :

- **Marrja e depozitave:** Bankat grumbullojnë kursimet e individëve dhe bizneseve.
- **Dhënia e kredive:** Një pjesë e depozitave huazohet tek klientët që kanë nevojë për financim, duke nxitur investimet dhe konsumin.
- **Krijimi i parasë së re:** Çdo kredi e dhënë shpesh shoqërohet me krijimin e një depozite të re në llogarinë e huamarrësit.
- **Fitimi përmes interesit:** Bankat fitojnë nga interesi mbi kreditë, duke kompensuar rrezikun e huadhënies.
- **Menaxhimi i rrezikut:** Bankat vlerësojnë huamarrësit për të minimizuar rrezikun e mospagesës.

Rëndësia e kredithënies bankare:

- Siguron kapital për zgjerimin e bizneseve, punësimin e njerëzve dhe blerje të mëdha nga individët.
- Vepron si një ndërmjetës, duke drejtuar fondet nga kursimtarët tek ata që investojnë dhe shpenzojnë.
- Lehtëson kryerjen e transaksioneve të përditshme dhe atyre të mëdha ekonomike.
- Norma e interesit dhe kostot e huazimit ndikojnë vendimet për huazim dhe kursim të familjeve dhe bizneseve.
- Zvogëlon rrezikun duke vlerësuar huamarrësit sipas “5 C-ve të Kreditit” :
 1. Character (Karakteri) – Besueshmëria e klientit
 2. Capacity (Kapaciteti) – Aftësia për shlyerjen e huasë
 3. Capital (Kapitali) – Pasuritë e klientit
 4. Collateral (Kolaterali) – Garancitë e dhëna
 5. Conditions (Kushtet) – Situata ekonomike dhe qëllimi i kredisë

Pyetje për reflektim

- Pse është e rëndësishme që bankat të veprojnë si ndërmjetës midis kursimtarëve dhe huamarrësve?
- Si ndikon kredithënia në zhvillimin ekonomik të një vendi?
- Cili nga “5 C-të” është më i rëndësishëm për një kredi konsumatore dhe pse?

10.2. Institucionet kredithënëse

Institucionet kredithënëse janë entitete financiare që ofrojnë kredi dhe hua për individë, biznese ose institucione të tjera. Ato luajnë rol thelbësor në zhvillimin ekonomik, sepse u mundësojnë klientëve të përmbushin nevoja financiare të menjëhershme, duke paguar më vonë nëpërmjet kësteve.

Në Shqipëri, institucionet kredithënëse ndahen kryesisht në dy kategori kryesore:

1. **Bankat** janë institucione financiare të licencuara dhe të mbikëqyrura nga **Banka e Shqipërisë**, që ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh:
 - Marrje depozitash dhe ruajtje fondesh për klientët;
 - Dhënie kredish për individë dhe biznese;
 - Kryerje pagesash, transfertash dhe shërbimesh të tjera bankare;
 - Ofrim i produkteve të kursimit dhe investimit (bono, depozita afatgjata etj.).

Aktualisht në Shqipëri operojnë **11 banka tregtare**, shumica me kapital të huaj, por edhe disa me kapital vendas.

2. **Subjektet financiare jobanka (institucionet financiare jobankare)** janë institucione nuk pranojnë depozita nga publiku, por ofrojnë kredi, mikrokredi ose financime alternative, shpesh me kushte më të lehta dhe procedura më të shpejta. Edhe këto janë të licencuara dhe mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë.

Shembuj të subjekteve jobanka:

- Shoqëritë e mikrokredisë (p.sh., “Fondacioni BESA”);
- Shoqëritë e leasing-ut (qiradhënies financiare);
- Shoqëritë faktoringu (blerje faturash ose detyrimesh tregtare);
- Shoqëritë e kredisë konsumatore ose kredit kartave.

Detyrë: Kërko një shembull konkret të një institucioni mikrokredie në Shqipëri dhe përshkruaj shërbimet e tij.

10. 3. Faktorët që ndikojnë në vendimin për dhënien e një kredie

Përpara se të miratojë një kredi, çdo bankë ose institucion financiar analizon me kujdes klientin, për :

- të vlerësuar riskun e huamarrësit dhe për të siguruar kthimin e huasë.
- të mbrojtur kapitalin dhe reputacionin e institucionit.
- të vendosur kushtet e kredisë (shuma, afati, norma e interesit, kolateralet).

Kjo analizë ndihmon bankën të mbrojë kapitalin e vet dhe të shmangë humbjet, por njëkohësisht siguron që kredia të jepet në mënyrë të përgjegjshme dhe të qëndrueshme.

Faktorët kryesorë që ndikojnë në vendimin e dhënies së kredisë:

Historiku i kreditit: Banka kontrollon nëse klienti ka kredidhënie të mëparshme, nëse i ka përmbushur detyrimet. Një histori e mirë kredie tregon përgjegjësi dhe rrit besueshmërinë.

Të ardhurat dhe burimet e tyre: Sa më të qëndrueshme të jenë të ardhurat e klientit (nga paga, qira, biznesi etj.), aq më e sigurt është shlyerja e kredisë.

Aftësia paguese: Llogaritet përmes raportit borxh/të ardhura. Në përgjithësi, nëse këstet mujore nuk kalojnë 40% të të ardhurave neto, klienti konsiderohet i qëndrueshëm financiarisht.

Kapitali dhe kolateralet: Banka vlerëson nëse klienti ka pasuri që mund t’i shërbejnë si garanci (si pasuri të paluajtshme, depozita apo bono thesari).

Kushtet ekonomike dhe sektoriale: Gjendja e përgjithshme e ekonomisë, inflacioni, normat e interesit dhe qëndrueshmëria i sektorit ku vepron klienti ndikojnë në vendimmarrje.

Qëllimi i kredisë: Vlerësohet nëse kredia do të përdoret për qëllime produktive (si investim apo blerje aktivesh) apo konsumatore, sepse kjo ndikon në riskun dhe afatin e kredisë.

Karakter i klientit: Vlerësohen korrektësia, qëndrueshmëria personale dhe reputacioni i tij financiar. Një klient me qëndrim të ndershëm dhe komunikim të hapur me bankën shihet si më i besueshëm.

Pyetje për reflektim

- Si do ta vlerësoje një klient që ka të ardhura të larta, por jo të qëndrueshme?

10.4. Veprimtari praktike: Aplikimi për kredi

Procesi i aplikimit për kredi është hapi i parë që lidh klientin me bankën. Ai synon të mbledhë të gjitha informacionet e nevojshme për të vlerësuar nëse klienti i plotëson kushtet për marrjen e kredisë dhe për të përcaktuar termat e saj.

Një aplikim i plotësuar me kujdes ndihmon bankën të kuptojë qëllimin e kredisë, gjendjen financiare të klientit, si dhe aftësinë e tij paguese.

Hapat kryesorë të aplikimit për kredi:

1. **Informimi në bankë:** Klienti kontakton bankën për të marrë informacion mbi llojet e kredive (hipotekore, konsumatore, biznesi etj.), normat e interesit, afatet dhe kushtet e shlyerjes.

Banka është e detyruar të ofrojë informacione të qarta dhe të krahasueshme për të gjitha ofertat e saj.

2. **Plotësimi i formularit të aplikimit:** Klienti jep të dhëna personale, kontaktet, të ardhurat dhe qëllimin e kredisë. Ky formular është dokumenti bazë që nxit procesin e analizës.

3. **Dorëzimi i dokumenteve kryesore që kërkon banka:**

- Dokument identifikimi (letërnjoftimi ose pasaporta)
- Dokumente të të ardhurave (fletëpagesa, deklarata tatimore, bilance, kontrata pune)
- Dokumente për kolateralin nëse kërkohet garanci pasurore
- Formulari i aplikimit i plotësuar

4. **Vlerësimi paraprak nga banka:** Pas dorëzimit të dokumenteve, banka analizon situatën financiare të klientit dhe vendos nëse aplikimi mund të kalojë në fazën e analizës së thelluar të kredisë.

5. **Komunikimi i vendimit paraprak:** Nëse aplikimi paraprak është i plotë dhe i justifikuar, klienti njoftohet për hapat e mëtejshëm. Në rast mospërputhjeje, banka mund të kërkojë dokumente shtesë ose të refuzojë aplikimin me argumentim të qartë.

Pyetje për reflektim

- Pse banka kërkon dokumente për të ardhurat dhe kolateralin?
- Çfarë ndodh nëse klienti nuk plotëson dokumentet e nevojshme?

10.5. Analiza e klientit dhe vlerësimi i aftësisë paguese

Analiza e klientit është procesi përmes të cilit banka vlerëson karakterin, qëllimin dhe gjendjen financiare të personit ose biznesit që kërkon kredi.

Qëllimi është të sigurohet që klienti është i besueshëm dhe në gjendje të kthejë kredinë sipas marrëveshjes.

Në këtë fazë, banka synon të:

- kuptojë mundësitë reale të klientit për ta shlyer kredinë;
- verifikojë qëndrueshmërinë e të ardhurave dhe burimet e pagesës;
- parashikojë rreziqet që mund të ndikojnë në shlyerjen e detyrimeve.

Procesi i analizës së klientit në praktikë

1. Mbledhja e të dhënave financiare

- Të ardhurat mujore (nga paga, biznesi, qira etj.)
- Shpenzimet e përmuajshme të familjes ose biznesit
- Detyrimet ekzistuese (kredi të tjera, këste, sigurime)
- Garancitë apo pasuritë e ofruara
- Dokumentet mbështetëse (fletëpagesa, bilance, vërtetime bankare)

2. Verifikimi i të dhënave

- Krahësimi i të ardhurave të deklaruara me dokumentet reale.
- Kontrolli i qëndrueshmërisë së burimeve të të ardhurave në 6–12 muajt e fundit.
- Vlerësimi nëse shpenzimet janë realiste për nivelin e të ardhurave.

3. Llogaritja e aftësisë paguese

Aftësia paguese matet përmes **raportit borxh/të ardhura**: $\text{Raporti i borxhit} = (\text{Këstet mujore të kredisë} \div \text{Të ardhurat mujore neto}) \times 100$

- Deri në 40% → aftësi e mirë paguese
- 40–50% → aftësi mesatare, kërkohet kujdes
- Mbi 50% → rrezik i lartë për mospagesë

4. Analiza e mbulimit me kolateral

Zakonisht kërkohet që kolaterali të ketë vlerë të barabartë ose më të lartë se shuma e huasë. Një kolateral i vlefshëm rrit sigurinë e bankës.

5. Hartimi i raportit të analizës

Specialistët e kredisë, përgatisin raportin përfundimtar, ku përfshihen të dhënat financiare, vlerësimi i riskut dhe rekomandimi: “Kredia miratohet” ose “Kredia refuzohet për shkak të rrezikut të lartë.

Pyetje për reflektim

- Cili do të ishte ndikimi nëse të ardhurat e klientit ndryshojnë gjatë periudhës së kredisë?

10. 6. Risku (rreziku) kreditor

Risku kreditor është mundësia që një klient të mos e shlyejë kredinë sipas kushteve të marrëveshjes. Ky është një nga rreziqet kryesore që përballen institucionet kredidhënëse në aktivitetin e tyre, sepse mos-shlyerja e kredive mund të shkaktojë humbje financiare për institucionin dhe të ndikojë në qëndrueshmërinë financiare të tij.

Në mënyrë të thjeshtë, risku kreditor do të thotë rreziku i mospagesës së borxhit nga klienti.

Pse ndodh risku kreditor?

- Për shkak të vështirësive financiare të klientit (p.sh. humbje të të ardhurave ose shpenzime të papritura).
- Për shkak të mungesës së planifikimit financiar nga klienti.
- Për shkak të faktorëve të jashtëm ekonomikë, si papunësia, kriza ekonomike ose inflacioni i lartë.

Faktorët që e shkaktojnë riskun kreditor:

- Dhënia e kredive pa analizë të thelluar të klientit;
- Dokumentacion i pasaktë ose i pamjaftueshëm;
- Mbivlerësim i kolateralit;
- Ndryshime të papritura në të ardhurat e klientit;
- Kriza ekonomike apo rritje e papritur e normave të interesit;
- Mungesë ndjekjeje dhe kontrolli të rregullt nga banka.

Banka kufizon rrezikun e mos-shlyerjes së kredive duke analizuar aftësinë paguese të klientit, kërkuar kolateral si garanci, vendosur limite për shumën e kredisë, diversifikuar portofolin në fusha të ndryshme, monitoruar pagesat, klasifikuar kreditë sipas rrezikut dhe krijuar provigjione për të mbuluar humbjet e mundshme.

Pyetje për reflektim

- Si ndihmon monitorimi periodik i kredive në reduktimin e rrezikut?

10.7. Kuptimi dhe roli i kolateralit (garancisë) në kredidhënie

Kolaterali (garancia) është një pasuri që huamarrësi (klienti) i ofron bankës si sigurim për kthimin e kredisë. Nëse klienti nuk arrin të shlyejë detyrimet, banka ka të drejtë të përdorë kolateralin për të rikuperuar shumën e papaguar. Kolaterali është një mjet mbrojtës për bankën, por edhe një garanci serioziteti për klientin, që tregon gatishmërinë e tij për të përmbushur detyrimet.

Qëllimi i kolateralit:

- Ul rrezikun kreditor për bankën.
- Rrit përgjegjshmërinë e klientit ndaj shlyerjes së detyrimit.
- Siguron garanci ligjore për rikuperimin e shumës së kredisë në rast mospagese.
- Ndikon në kushtet e kredisë, sa më i vlefshëm kolaterali, aq më të favorshme mund të jenë normat e interesit.

Llojet e zakonshme të kolateralit:

- Pasuri të paluajtshme (banesa, toka, truall);
- Pasuri të luajtshme (automjete, makineri, pajisje);
- Depozita bankare, bono thesari ose garanci financiare;
- Dorëzanë (garant) që merr përsipër pagesën e kredisë në rast mospagese.

Vlerësimi dhe regjistrimi i kolateralit

- Banka kërkon vlerësim profesional të pasurisë nga ekspertë të licencuar;
- Kolaterali regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ose në Regjistrin e Sigurimeve të Kolateralit;
- Gjatë periudhës së kredisë, banka mban të drejtën e pengut mbi kolateralin deri në shlyerjen e plotë të huasë.

Kolaterali nuk zëvendëson aftësinë paguese të klientit, por e plotëson analizën e rrezikut. Një kolateral i vlefshëm e bën kredinë më të sigurt si për bankën ashtu edhe për klientin.

Pyetje për reflektim

- Një klient kërkon kredi 4,000,000 lekë. Nëse banka kërkon mbulim 130%, sa duhet të jetë vlera minimale e kolateralit?

10.8. Përlllogaritja e interesit dhe këstit mujor

Çdo kredi përfshin dy pjesë kryesore: shumën e marrë hua (kapitalin) dhe interesin, që është shpërblimi i bankës për përdorimin e parave. Kësti K përfshin interesin dhe shlyerjen e kapitalit.

Ku:

- K – kësti mujor
- P – shuma e kredisë (kapitali)
- r – norma mujore e interesit = (norma vjetore / 12)
- n – numri total i kësteve (muajve)

Nëse shuma dhe periudha e kredisë mbeten të njëjta, një normë interesi më e ulët do të sjellë këste më të vogla, ndërsa një normë më e lartë do të bëjë këstet më të mëdha.

✓ Parimi bazë i kësteve të pabarabarta

Te këstet e pabarabarta, interesi ulet çdo muaj, pasi llogaritet mbi kapitalin e mbetur (principalin) ndërsa kapitali ndahet në n pjesë të barabarta ($K_{kap} = P/n$)

Interesi për çdo muaj llogaritet mbi shumën e mbetur të kredisë ($I_i = P_{i-1} \times r$), ku P_{i-1} është shuma e mbetur para pagesës së muajit i .

Kësti total i muajit = kapitali i shlyer + interesi i muajit

Shembull : Kredi 120,000 lekë, afat 12 muaj, interes vjetor 12%.

Muaji	Shuma e mbetur	Interesi(1%)	Kapitali	Kësti total
1	120'000	1'200	10'000	11'200
2	110'000	1'100	10'000	11'100
3	100'000	1'000	10'000	11'000

- Vazhdoni përlllogaritjen e planit të pagesës së kësaj kredie.

✓ Parimi bazë i kësteve të barabarta

Kur kredia ka këste të barabarta, përdoret formula: $K = P \times \frac{r(1+r)^n}{(1+r)^n - 1}$

Me kalimin e kohës, pjesa e interesit zvogëlohet, ndërsa pjesa e kapitalit rritet, por kësti total mbetet konstant.

Duke iu referuar të dhënave tek shembulli më lart, zëvendësojmë formulën:

$$K = 120'000 \times \frac{0,01(1+0,01)^{12}}{(1+0,01)^{12}-1} \quad \text{ku: } (1+0,01)^{12} = 1,1268$$

$$K = 120'000 \times \frac{0,01(1+0,01)^{12}}{(1+0,01)^{12}-1} = 120'000 \times \frac{0,01 \times 1,1268}{1,1268-1}$$

$$K = 120'000 \times \frac{0.011268}{0,1268} = 120'000 \times 0,0889 = 10'668 \text{ lekë}$$

Muaji	Shuma e mbetur	Interesi(1%)	Kapitali	Kësti total
1	120'000	1'200	9'468	10'668
2	110'532	1'105	9'563	10'668
3	100'969	1'009,69	9'658,31	10'668

➤ Vazhdoni përlllogaritjen e planit të pagesës së kësaj kredie.

10.9. Dokumentimi dhe arkivimi i dosjes së kredisë

Dokumentimi i kredisë përfaqëson mbledhjen, verifikimin dhe përgatitjen e të gjitha dokumenteve ligjore, financiare dhe administrative që lidhen me dhënien, menaxhimin dhe shlyerjen e një kredie. Çdo dokument shërben si provë ligjore e marrëdhënies midis bankës dhe klientit.

Kur dokumentet e kredisë përgatiten me kujdes, ato ndihmojnë që:

- procesi i miratimit të jetë i qartë dhe transparent
- rreziku i klientit të vlerësohet në mënyrë të drejtë dhe të saktë
- banka të ketë një bazë ligjore në rast mospagese ose mosmarrëveshjeje
- të ruhet historiku i marrëdhënieve financiare të klientit, për përdorime të ardhshme.

Një dosje kredie përmban zakonisht:

- ✓ Dokumente të aplikimit: kërkesa për kredi, plotësuar nga klienti me ndihmën e specialistit.
- ✓ Dokumente identifikimi: kopje e kartës së identitetit ose pasaportës për klientin dhe bashkëkredimarrësin.
- ✓ Dokumente financiare: vërtetim page, balance apo deklarata e të ardhurave për vlerësimin e aftësisë paguese dhe dokumente që vërtetojnë pronësinë e pasurisë, nëse ofrohet si kolateral.
- ✓ Dokumente të miratimit: vendimi i komitetit (komisionit) të kredisë, fleta e aprovimit të kushteve të kredisë.
- ✓ Dokumente ligjore: kontrata e kredisë, e kolateralit, aktet noteriale përkatëse dhe kontrata e dorëzansisë (nëse parashikohet).
- ✓ Dokumente të monitorimit: plani i shlyerjes së kredisë dhe raportet e ndjekjes gjatë periudhës së kredisë.

Regjistri i kredive dhe përdorimi i informacionit: Përveç dokumenteve të brendshme, bankat në Shqipëri përdorin Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë (BOA) për të mbledhur dhe shkëmbyer informacion mbi huamarrësit. Ky informacion është i aksesueshëm vetëm për personelin e autorizuar të bankave dhe shërben si mbështetje shtesë për analizën e aftësisë paguese të klientit, duke plotësuar dosjen e kredisë dhe dokumentimin e saj.

Arkivimi: Pas miratimit dhe nënshkrimit të kontratës, dosja arkivohet fizikisht ose në mënyrë digjitale, sipas kodit unik të klientit dhe mund të përdoret vetëm nga personeli i autorizuar i bankës. Dosjet arkivohen për një periudhë 5–10 vjet pas shlyerjes së plotë të kredisë, në përputhje me politikat e bankës dhe udhëzimet e Bankës së Shqipërisë.

Pyetje për reflektim

- Pse është e nevojshme të ruhen dosjet edhe pas shlyerjes së kredisë?

Tema 11: Kushtet e kredidhënies

11.1. Kushtet e kredidhënies

Kushtet e kredidhënies përfaqësojnë rregulla dhe kritere që banka vendos përpara miratimit të një kredie. Ato garantojnë që huaja t’u jepet vetëm klientëve me aftësi paguese, duke ulur rrezikun e mospagimit dhe duke ruajtur ekuilibrin financiar të bankës.

Këto kushte përfshijnë elemente si:

- **Të ardhurat dhe aftësia paguese:** banka analizon sa nga të ardhurat mujore mund të shkojnë për këstin e kredisë, pa e vënë në rrezik jetesën ose shpenzimet tjera të klientit.
- **Qëllimi i kredisë:** kredia duhet të përdoret për një qëllim të ligjshëm dhe të qartë – për shembull, blerja e një shtëpie, zgjerimi i biznesit apo financimi i arsimit.
- **Garancia** (kolaterali): banka kërkon një pasuri ose sigurim që mbulon shumën e huasë, për të siguruar rikuperimin e kredisë në rast mospagimese.
- **Afati dhe mënyra e shlyerjes:** përcaktohet koha brenda së cilës klienti duhet të shlyejë kredinë dhe mënyra (këste fikse, variabël, overdraft).
- **Norma e interesit dhe kostot shtesë:** këto ndikojnë drejtpërdrejt në madhësinë e këstit dhe koston totale të kredisë.

Përmes këtyre kushteve, banka mbron veten nga humbjet financiare ndërsa klienti shmang mbingarkesën me detyrime dhe ruan kredibilitetin e tij financiar.

Banka e Shqipërisë përcakton rregulloret dhe standardet për dhënien e kredive, duke mbikëqyrur zbatimin e politikave bankare dhe duke siguruar mbrojtjen e konsumatorit dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar.

Pyetje për reflektim

- Pse është e rëndësishme që kredia të ketë qëllim të qartë dhe të ligjshëm?

11.2. Kriteret e miratimit të kredive

Kriteret e miratimit të kredive janë rregulla që banka përdor për të vlerësuar nëse një klient mund të marrë dhe të shlyejë kredinë në mënyrë të sigurt.

Qëllimi i tyre është të sigurohet që huaja jepet vetëm klientëve me aftësi paguese, duke minimizuar rrezikun e humbjes për bankën.

Politikat e brendshme të bankës përcaktojnë procedurat e vlerësimit, kufijtë maksimalë të riskut, normat e interesit dhe nivelin e miratimit (nga zyra e degës apo komiteti i kredisë).

Banka e Shqipërisë ka rolin e mbikëqyrjes dhe rregullimit, duke përcaktuar përmes rregulloreve të saj:

- standardet e analizës së riskut;
- mënyrën e raportimit të kredive;
- kërkesat për kapital të mjaftueshëm;
- mbrojtjen e konsumatorit dhe transparencën në dhënien e kredive.

Këto rregulla sigurojnë që çdo kredi të miratohet në mënyrë të drejtë, transparente dhe të qëndrueshme financiarisht.

Rast studimor

Biznesi “X” ka kërkuar një kredi prej 500’000 lekësh për të blerë pajisje të reja dhe zgjeruar aktivitetin. Të ardhurat mujore të biznesit janë 200’000 lekë, ndërsa ka një detyrim ekzistues për një kredi tjetër me kështu mujor 50’000 lekë. Kolaterali i ofruar përfshin një makinë të vjetër dhe një depozitë bankare prej 100’000 lekësh.

- Jepni vendimin tuaj: A duhet të aprovohet kredia? Pse po ose pse jo?

11.3. Aftësia paguese e klientit

Aftësia paguese e klientit është mundësia reale e klientit për të përballuar pagesat mujore të kredisë, pa ndikuar negativisht në nevojat e tij jetike apo detyrimet e tjera financiare. Ajo tregon sa pjesë të të ardhurave mujore mund t’i dedikohen shlyerjes së kredive. Banka e vlerëson këtë aftësi për të siguruar që kredia do të shlyhet në afat dhe për të shmangur rrezikun e mospagimit.

Elementet që ndikojnë në aftësinë paguese:

- Të ardhurat mujore – paga, pensioni, të ardhurat nga biznesi apo burime të tjera.
- Shpenzimet fikse – qira, fatura, shpenzime familjare.
- Detyrimet ekzistuese – kredi të tjera, këste, borxhe.
- Numri i anëtarëve në familje – ndikon në nivelin e konsumit.
- Qëndrueshmëria e të ardhurave – nëse punësimi është i qëndrueshëm apo i përkohshëm.

Kursimi mujor lidhet me aftësinë paguese dhe është diferenca midis të ardhurave totale dhe shpenzimeve fikse, që tregon shumën që klienti mund t’i dedikojë kështu të kredisë.

Kursimi mujor = të ardhurat mujore – (shpenzimet +detyrimet ekzistuese)

Rasti studimor

Biznesi “Y” ka kërkuar një kredi prej 400’000 lekësh për blerje pajisjesh. Të ardhurat mujore janë 220’000 lekë, shpenzimet fikse 180’000 lekë dhe detyrimet ekzistuese për kredi janë 40’000 lekë. Kursimi mujor është $220'000 - (180'000 + 40'000) = 0$ lekë, që tregon se biznesi nuk ka mjaftueshëm kursim për të mbuluar koston e kredisë. Megjithatë, specialisti i kredisë vendos ta financojë kërkesën për shkak të pritshmërive për fitim të ardhshëm ose marrëdhënie të mëparshme me klientin.

Diskutoni:

- Cilat mund të jenë pasojat e dhënies së kredisë kur aftësia paguese nuk përmbushet?
- Si mund të veproni ju për të vlerësuar rrezikun? Cilat masa mund të sugjeroni për bankën ose klientin për të reduktuar rrezikun e mospagimit?

11.4.Veprimtari praktike: Analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve

Ushtrim: Llogarit kursimin mujor për të vlerësuar aftësinë paguese të një biznesi për kredi.

Të dhënat nga dosja e kredisë :

- Të ardhurat mujore: 350’000 lekë (shitje produktesh dhe ofrimi i shërbime)
- Shpenzimet fikse mujore:
 - qira dyqani: 35’000 lekë
 - fatura energjie dhe uji: 8’000 lekë
 - paga staf: 150’000 lekë
 - blerje materiale: 40’000 lekë
 - marketing dhe reklamë: 5’000 lekë
 - shpenzime administrative: 7’000 lekë
- Detyrimet ekzistuese: kësti i kredisë bankare 25’000 lekë
- Numri i stafit: 3 punonjës
- Qëndrueshmëria e të ardhurave: biznes i qëndrueshëm 2 vjet

Udhëzime: Përdor formulën për të llogaritur kursimin mujor:

Kursimi mujor = të ardhurat mujore – (shpenzimet +detyrimet ekzistuese)

11.5 Norma e interesit dhe komisionet e kredisë

Në sistemin bankar shqiptar, kostoja e një kredie përfshin normën e interesit dhe komisionet që banka aplikon për shërbimet e saj. Këto elementë ndikojnë drejtpërdrejt në koston totale të kredisë për klientin dhe në madhësinë e kësteve që klienti duhet të paguajë.

Norma e interesit është çmimi që klienti paguan për përdorimin e parave të huasë. Ajo mund të jetë:

- **E fiksuar**, që mbetet e pandryshuar gjatë gjithë periudhës së kredisë;
- **E ndryshueshme**, që përcaktohet sipas treguesve financiarë. Për kreditë në euro përdoren norma si EURIBOR (European Interbank Offered Rate) apo LIBOR (London Interbank Offered Rate), (London Interbank Offered Rate). Ndërsa për kreditë në lekë, referenca

shpesh lidhet me bonot e thesarit të emetuara nga Ministria e Financave, të cilat pasqyrojnë koston e parasë në tregun vendas.

Norma e interesit ndikon drejtpërdrejt në aftësinë paguese të klientit, ndaj bankat janë të detyruara nga Banka e Shqipërisë të njoftojnë çdo ndryshim dhe ta përfshijnë qartë në kontratë.

Komisionet janë tarifa shtesë që bankat aplikojnë për shërbimet e ofruara si:

- Komisioni i çeljes së kredisë, për shqyrtimin dhe miratimin e saj.
- Komisioni i menaxhimit, për administrimin periodik të kredisë.
- Komisioni për shlyerjen e parakohshme, kur kredia shlyhet para afatit.

Të gjitha tarifat dhe normat e interesit duhet të jenë të përcaktuara qartë në kontratë, në përputhje me ligjet për mbrojtjen e konsumatorit dhe rregulloret e Bankës së Shqipërisë, në mënyrë që të sigurohet transparencë dhe mbrojtje e klientit.

Rast studimor :

Një klient kërkon një kredi prej 100'000 lekësh me normë interesi 6% dhe komision administrimi 2'000 lekë.

Diskutoni: Si ndryshon kostoja reale e kredisë nëse banka vendos të ndryshojë normën e interesit gjatë jetës së huasë? Cilat masa duhet të marrë klienti për të mbrojtur interesin e tij?

11.6. Llogaritja e normës efektive e interesit (NEI)

Norma efektive e interesit (NEI) përfaqëson koston reale që klienti paguan për një kredi, duke përfshirë jo vetëm normën nominale të interesit, por edhe të gjitha komisionet, tarifat dhe shpenzimet shtesë që lidhen me marrjen dhe administrimin e kredisë. Ky tregues ndihmon klientët të krahasojnë në mënyrë të drejtë ofertat e kredive nga banka të ndryshme dhe të zgjedhin opsionin më të leverdishëm.

Norma nominale e interesit është përqindja që banka shpall publikisht dhe përdoret për llogaritjen e interesit mbi shumën e huasë, pa marrë parasysh tarifat ose komisionet shtesë. Ndërsa Norma Efektive e Interesit (NEI) përfshin të gjitha kostot reale të kredisë, duke pasqyruar më saktë çmimin total që klienti paguan. Ajo tregon se sa kushton në të vërtetë huaja, duke marrë parasysh interesin, komisionet për administrim, komisionet e hapjes dhe çdo tarifë tjetër të aplikueshme. Bankat janë të detyruara nga Banka e Shqipërisë që të përfshijnë NEI-në në kontratën e kredisë dhe ta bëjnë të qartë për klientin para nënshkrimit, në mënyrë që klienti të ketë një informacion të plotë për koston reale të huasë. Kjo praktikë siguron transparencë dhe ndihmon klientët të marrin vendime të informuara financiare, duke krahasuar ofertat e ndryshme bankare në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Formula e Normës Efektive të Interesit (NEI):

$$NEI = \frac{(\text{Pagesa totale e kredisë} - \text{Shuma e marrë})}{\text{Shuma e marrë}} \times 100$$

Ku:

- **Pagesa totale e kredisë** = shuma e të gjitha kësteve që klienti paguan gjatë periudhës (interes + principal + komisione),
- **Shuma e marrë** = vlera fillestare e huasë që klienti përfiton.

Kjo shprehje tregon përqindjen që përfaqëson kostoja reale e kredisë mbi shumën e marrë hua.

Shembull:

Një klient merr një kredi prej 100'000 lekësh me normë nominale 6% për 1 vit dhe paguan 2'000 lekë komision.

- Llogaritja e interesit nominal: $100'000 \times 6\% = 6'000$ lekë
- Llogaritja e pagesës totale: $100'000 + 6'000 + 2'000 = 108'000$ lekë

$$\frac{108'000 - 100'000}{100'000} \times 100 = 8\%$$

- Llogaritja e NEI :

Pra, edhe pse norma nominale është 6%, NEI rezulton 8% për shkak të komisioneve, duke treguar koston reale të kredisë.

Ushtrim:

Klienti X është financuar nga një bankë e nivelit të dytë me një kredi prej 200'000 lekë, kohëzgjatja, 12 muaj, me normë interesi 7% në vit dhe komision çelje kredie 4'000 lekë.

Llogarit koston totale që klienti do të paguajë në fund të vitit dhe shpjego me fjalët e tua pse komisionet ndikojnë në çmimin real të kredisë.

11.7. Afati dhe mënyrat e shlyerjes së kredisë

Afati i kredisë është periudha kohore brenda së cilës huamarrësi duhet të shlyejë shumën e marrë dhe interesin përkatës. Ai përcaktohet në kontratë dhe ndikon drejtpërdrejt në madhësinë e kësteve: për një shumë caktuar, sa më i gjatë të jetë afati, aq më të vogla janë pagesat mujore, por rritet interesi total që paguhet.

Në praktikë, bankat përshtatin afatin dhe mënyrën e shlyerjes sipas llojit të kredisë dhe mundësive të klientit. Për bizneset, kreditë për kapital qarkullues zakonisht kanë afate më të shkurtra, pasi synojnë mbulimin e nevojave të përkohshme për likuiditet, ndërsa kreditë për investime në aktive fikse (p.sh. makineri, pajisje apo pasuri të paluajtshme) kanë afate më të gjata për shkak të vlerës më të lartë dhe kthimit më të ngadaltë të investimit.

Edhe për individët, afatet ndryshojnë sipas qëllimit të huasë: kreditë konsumatore janë zakonisht afatshkurtra, ndërsa kreditë hipotekare (për blerje banese) kanë afate shumë më të gjata, që mund të zgjasin deri në disa vite apo dekada.

Mënyrat kryesore të shlyerjes janë:

- **Kredi me këste fikse:** Huamarrësi paguan të njëjtin këst çdo muaj gjatë gjithë periudhës. Ky model ofron qëndrueshmëri dhe lehtësi në planifikimin e buxhetit nga ana e klientit.
- **Kredi me këste të ndryshueshme (variabël):** Shuma e këstit ndryshon sipas luhatjeve të normës së interesit. Nëse tregjet rriten, kësti mund të rritet, ndërsa në periudha me norma më të ulëta, pagesa ulet. (kujtoni normën e ndryshueshme të kredisë)
- **Overdrafti:** Është një formë kredie afatshkurtër që lidhet me llogarinë rrjedhëse të klientit, e cila lejon përdorimin e fondeve përtej gjendjes aktuale në llogari. Interesi paguhet vetëm për shumën e përdorur.

Zgjedhja e mënyrës së shlyerjes duhet bërë me kujdes, duke marrë parasysh qëndrueshmërinë e të ardhurave të huamarrësit dhe mundësinë reale për të përballuar detyrimet në afat.

Pyetje për reflektim

- Një klient ka mundësi të zgjedhë midis dy opsioneve: kredi 3-vjeçare me këste fikse ose kredi 5-vjeçare me këste më të ulëta, por interes më të lartë total. Cilin opsion do të zgjidhje nëse do të ishe klienti? Argumento shkurtimisht përgjigjen tënde.

11.8. Rastet e mospagimit të kredive

Mospagimi i kredisë ndodh kur klienti nuk arrin të shlyejë këstet sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Kjo situatë përbën një rrezik të rëndësishëm si për bankën, ashtu edhe për vetë klientin, pasi ndikon në historikun e tij financiar dhe mundësinë për të marrë kredi në të ardhmen.

Shkaqet e mospagimit mund të jenë të ndryshme: humbja e vendit të punës, ulja e të ardhurave, menaxhimi i dobët i buxhetit, apo faktorë të jashtëm ekonomikë si rritja e normave të interesit ose inflacioni. Në disa raste, mospagimi lidhet edhe me keqinformim të klientit për detyrimet e tij, ose me pritshmëri të gabuara për aftësinë paguese.

Kur klienti vonon pagesat, banka ndjek një proces të strukturuar për rikuperimin e kredisë, duke respektuar rregullat e përcaktuara nga Banka e Shqipërisë:

1. **Njoftimi i klientit** – banka kontakton huamarrësin për ta njoftuar për detyrimet e prapambetura dhe për të ofruar mundësi rinegociimi të afatit ose kësteve.
2. **Aplikimi i penaliteteve** – për çdo ditë vonesë, llogaritet interes shtesë sipas kontratës.
3. **Klasifikimi i kredisë** – nëse vonesat vazhdojnë, kredia kalon në një nga kategoritë “nën standard”, “e dyshimtë” ose “e humbur”, sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë për administrimin e riskut të kreditit.
4. **Rikuperimi i detyrimeve** – në fazat e mëvonshme, banka mund të kërkojë ekzekutimin e kolateralit ose ndjekje ligjore për të mbuluar detyrimin e pashlyer.

Në shumë raste, bankat përpiqen fillimisht të arrijnë marrëveshje me klientin, duke ristrukturuar kredinë, ulur këstin mujor, ose zgjatur afatin e pagesës. Kjo është një mënyrë për të shmangur humbjet për të dyja palët dhe për të ruajtur marrëdhënien e besimit ndërmjet klientit dhe institucionit financiar.

Pasojat për klientin janë serioze: përveç penalteteve financiare dhe mundësisë së humbjes së kolateralit, ai regjistrohet si “klient me probleme krediti” në Regjistrin e Kredive pranë Bankës së Shqipërisë, çka e pengon të marrë hua të tjera në të ardhmen.

11.9. Veprimtari praktike: Vlerësimi i një kërkesë për kredi

Biznesi “Aroma e Luleve” sh.p.k., një dyqan i vogël lulesh në qytet, ka kërkuar një kredi prej 400’000 lekësh për të rinovuar ambientin dhe për të shtuar gamën e produkteve me bimë zbukuruese.

Biznesi operon prej 3 vitesh, me të ardhura mesatare mujore 180’000 lekë dhe shpenzime fikse rreth 120’000 lekë. Aktualisht nuk ka detyrime të tjera bankare, por ka një kontratë qiraje 3-vjeçare për ambientin. Kolaterali i ofruar është një automjet furgon me vlerë tregu 500’000 lekë.

Banka po shqyrton nëse biznesi ka aftësi të mjaftueshme paguese për të përballuar kështet mujore dhe për të ruajtur likuiditetin e nevojshëm për aktivitetin e përditshëm.

Detyrë:

- Vlerësoni nëse “Aroma e Luleve” përmbush kriteret për miratimin e kredisë.
- Cilat janë elementet që mbështesin vendimin tuaj?
- Cilat masa paraprake do të sugjeronit që banka të marrë për të minimizuar rrezikun?

Tema 12: Llojet e kredive

12.1. Kreditë sipas qëllimit të përdorimit

Kreditë bankare klasifikohen shpesh sipas qëllimit për të cilin përdoren fondet e huazuara. Qëllimi i kredisë përcakton si natyrën e kontratës, ashtu edhe kushtet që banka vendos për klientin. Kjo ndarje është e rëndësishme sepse ndihmon bankën të vlerësojë rrezikun, afatin dhe mënyrën më të përshtatshme të shlyerjes. Llojet kryesore të kredive sipas qëllimit janë:

Kreditë konsumatore – jepen individëve për të përmbushur nevoja personale ose familjare, si blerja e pajisjeve shtëpiake, udhëtime, shpenzime shëndetësore apo arsimore. Zakonisht janë me vlera më të vogla dhe afate më të shkurtra shlyerjeje (1–5 vjet), me kolateral minimal ose pa të tillë.

Kreditë hipotekare – përdoren për blerjen, ndërtimin ose rikonstruksionin e banesave. Këto kredi janë afatgjata (deri në 30 vjet) dhe zakonisht kërkojnë kolateral pasurinë që blihet ose një garanci tjetër reale. Norma e interesit për këto kredi mund të jetë fikse ose e ndryshueshme.

Kreditë për biznese – financojnë zhvillimin e aktivitetit ekonomik, si blerje pajisjesh, investime në teknologji, apo zgjerim të prodhimit. Ato mund të ndahen më tej në kredi për kapital qarkullues

(afat më i shkurtër, për financimin e stokut ose furnizimeve) dhe kredi për investime në aktive fikse (afat më i gjatë, për makineri, ndërtesa apo mjete transporti).

Kreditë bujqësore – synojnë mbështetjen e fermerëve për prodhim bujqësor, blektori, ose përpunim produktesh. Zakonisht ofrohen me kushte të favorshme dhe me mbështetje nga programe shtetërore apo fonde zhvillimi.

Në praktikë, përzgjedhja e llojit të kredisë varet nga qëllimi i përdorimit dhe natyra e të ardhurave të huamarrësit. Një individ që kërkon të blejë një makinë do të marrë një kredi konsumatore, ndërsa një biznes që planifikon të hapë një filial të ri do të aplikojë për një kredi biznesi.

Pyetje për reflektim

- Pse është e rëndësishme që banka të dijë saktësisht për çfarë do të përdoret kredia?
- Cila lloj kredie mendoni se ka rrezikun më të madh për bankën dhe pse?

12.2. Kreditë sipas afatit të maturimit

Kreditë gjithashtu klasifikohen sipas afatit të maturimit, që është periudha kohore gjatë së cilës huamarrësi duhet të shlyejë shumën e marrë hua dhe interesin përkatës. Kjo ndarje është e rëndësishme sepse ndikon në planifikimin financiar të klientit dhe në rrezikun që merr banka.

Kreditë afatshkurtra, zakonisht janë me afat deri në 12 muaj. Ato mund të përdoren për financimin e nevojave të menjëhershme ose për kapital qarkullues të bizneseve të tilla si për financimin e furnizimeve apo pagat e punonjësve. Këto kredi kanë shpesh këste mujore të vogla dhe interes më të lartë për shkak të riskut të shkurtër dhe përdorimit të shpejtë të fondit.

Kreditë afatmesme, zakonisht shtrihen nga 1 deri në 5 vjet dhe përdoren për financime që e sjellin dobinë e tyre për një periudhë kohe mbi 1 vit, si zgjerimi i një biznesi ose blerja e pajisjeve të mëdha. Pagesat mujore janë të balancuara dhe interesi shpesh rezulton më i ulët krahasuar me kreditë afatshkurtra.

Kreditë afatgjata, zakonisht tejkalojnë 5 vjet dhe përdoren për financimin e pasurive të paluajtshme ose investimeve kapitale që kërkojnë shumë kohë për t'u realizuar, si kreditë hipotekare për blerjen e banesave, financimi i ndërtimit të ndërtesave ose blerja e pajisjeve industriale. Pagesat mujore shpërndahen mbi një periudhë të gjatë, duke i bërë më të menaxhueshme, megjithatë kostoja totale e interesit gjatë gjithë jetës së kredisë zakonisht rezulton më e lartë.

Pyetje për reflektim

- Pse banka ofron periudha të ndryshme maturimi për kredi të ndryshme?

12.3. Kreditë sipas mënyrës së disbursimit (çeljes) dhe shlyerjes

Kreditë mund të klasifikohen edhe sipas mënyrës se si banka disburson shumën dhe si klienti e shlyen atë. Kjo ndihmon në përshtatjen e produktit me nevojat e huamarrësit dhe likuiditetin e biznesit ose individit.

Kreditë me këste janë më të zakonshmet ku klienti merr shumën e plotë të kredisë në fillim dhe e shlyen me këste mujore ose periodike që përfshijnë kapitalin dhe interesin. Ky model jep qëndrueshmëri në planifikimin e buxhetit, sepse kësti është i parashikueshëm.

Kreditë me limit kreditor funksionojnë si një llogari krediti e hapur ku klienti mund të përdorë shumën sipas nevojës dhe paguan interes vetëm për shumën e përdorur. Shlyerja është fleksibël dhe mund të bëhet gradualisht, duke i dhënë mundësi menaxhimi më të mirë të likuiditetit.

Linjat e kredisë janë veçanërisht të dobishme për biznese që kanë nevoja të ndryshueshme për financim afatshkurtër. Banka vendos një kufi maksimal, dhe klienti tërheq fondet sipas projektit ose kërkesës, duke paguar interes vetëm mbi shumën e përdorur. Kjo formë i lejon klientëve të menaxhojnë më mirë rrjedhën e parasë dhe të shmangin pagesat e panevojshme kur nuk përdorin të gjithë shumën e kredisë menjëherë.

12.4. Kreditë konsumatore

Kreditë konsumatore janë kredi të caktuara për përdorim personal nga individët, si blerja e pajisjeve shtëpiake, automjeteve, financimin e pushimeve ose mbulimi i shpenzimeve për arsimim. Ato zakonisht ofrojnë afate më të shkurtra se kreditë për pasuri të paluajtshme, ndërsa norma e interesit ndryshon në varësi të shumës dhe kohëzgjatjes së huasë.

Karakteristikat kryesore të kredive konsumatore:

- ✓ Afat i shlyerjes zakonisht 6 muaj deri 5 vjet.
- ✓ Kësti mujor i parashikuar sipas normës së interesit dhe shumës së kredisë.
- ✓ Dokumentacion relativisht i thjeshtë.
- ✓ Vlerësimi i aftësisë paguese të klientit është i detyrueshëm për të shmangur rrezikun e mospagimit.

Avantazhet e kredisë konsumatore:

- Për individët, këto kredi sigurojnë shpejtësi dhe fleksibilitet për të përmbushur nevoja të menjëhershme.
- Planifikimi i pagesave mujore është më i kuptueshëm, pasi afatet janë relativisht të shkurtra.

Disavantazhet e kredisë konsumatore:

- Efekti financiar i interesit dhe tarifave mund të jetë i lartë nëse huaja nuk përdoret me përgjegjësi.
- Nëse kësti i kredisë merr pjesë të madhe të të ardhurave, jetesa e përditshme mund të bëhet e vështirë për klientin
- Kreditë konsumatore zakonisht nuk ofrojnë kohë të gjatë shlyerjeje si kreditë hipotekare, prandaj kostoja mujore mund të jetë më e rëndësishme për buxhetin familjar.

Pyetje për reflektim

- Pse është e rëndësishme të përcaktohet qartë qëllimi i kredisë kur merret kredi konsumatore?

12.5. Kreditë për bizneset

Kreditë për bizneset janë hua të ofruara për të mbështetur aktivitetin ekonomik të një kompanie, qoftë për financimin e kapitalit qarkullues, zgjerimin e aktivitetit, blerjen e pajisjeve apo investimeve në pasuri të paluajtshme. Këto kredi ndihmojnë bizneset të menaxhojnë flukset e tyre financiare, të rrisin kapacitetin prodhues dhe të përballojnë nevojat e përditshme të operimit të aktivitetit ekonomik.

Përveç elementëve bazë si qëllimi i kredisë, aftësia paguese, kolateralet dhe qëndrueshmëria e sektorit, bankat vlerësojnë edhe disa veçori shtesë të biznesit, të cilat mund të ndikojnë pozitivisht në miratimin e huasë:

Planifikimi i biznesit dhe strategjia e rritjes: Një planifikim i qartë dhe realist tregon se biznesi ka një vizion të qëndrueshëm dhe aftësi për të kthyer kredinë.

Eksperienca dhe menaxhimi i ekipit drejtues: Një ekip menaxhues me përvojë rrit besueshmërinë e biznesit për t'iu përmbajtur detyrimeve financiare.

Diversifikimi i burimeve të të ardhurave: Bizneset që kanë të ardhura nga disa aktivitete ose klientë të ndryshëm konsiderohen më pak të rrezikuara.

Përfitimet nga kredia: Banka mund të vlerësojë se kredia jo vetëm që mbulon nevojat aktuale, por edhe rrit mundësinë e fitimit dhe konkurrencën e biznesit.

Mundësia e garancive shtesë ose partneriteteve: Investime të mbështetura nga partnerë të fuqishëm ose kolateral shtesë mund të përmirësojnë kushtet e huasë.

Rast Studimor:

Biznesi “XX” kërkon një financim në shumën 800'000 lekë për të blerë pajisje të reja frigoriferike dhe për të zgjeruar aktivitetin. Të ardhurat mujore të biznesit janë 250'000 lekë, detyrimet ekzistuese për kredi të tjera janë 70'000 lekë, dhe kolaterali përfshin një depozitë bankare prej 150'000 lekësh dhe një makinë transporti. Planifikimi i biznesit tregon rritje të shitjeve dhe diversifikim të klientëve.

Analizoni aftësinë paguese, veçoritë shtesë dhe avantazhet e biznesit, dhe vendosni nëse kredia duhet të aprovohet apo jo, duke argumentuar vendimin tuaj si në një komitet kredie.

12.6. Produktet e reja të kredidhënies

Me zhvillimin e teknologjisë dhe ndryshimet në nevojat financiare, bankat po ofrojnë më shumë produkte të avancuara kredidhënieje për individë dhe biznese. Këto produkte sjellin fleksibilitet, shpejtësi dhe modele të reja financimi që nuk ishin të zakonshme më parë.

Kredi me aplikim online dhe vendim të automatizuar (instant loan): Në disa institucione kredidhënëse ofrohet mundësia klientëve të aplikojnë plotësisht online dhe të përfitojnë financimin e kërkuar brenda pak minutash.

Financime për bizneset me fokus në teknologji, blerje makinerish ose rikonstrukcion.

Leasing dhe financime për pajisje/automjete: Një tjetër formë kredie e re është leasing-u, ku klienti përfiton pajisjen ose automjetin, ndërsa pronësia transferohet gradualisht.

Kredia për bizneset dhe klientët me fokus në qëndrueshmërinë dhe investimet „green”: Disa banka tashmë ofrojnë linja financimi për projekte me efikasitet energjetik, në bashkëpunim me institucione ndërkombëtare.

Avantazhet kryesore të këtyre produkteve:

- Aplikim më i shpejtë dhe procesim elektronik, kursim kohe dhe më pak dokumente.
- Fleksibilitet më i madh, mund të përdorësh linjën e kredisë sipas nevojës ose të zgjedhësh leasing në vend të huasë klasike.
- Më shumë mundësi për klientë që kanë projekte specifike, si rinovime banesash, pajisje teknologjike ose investime biznesi.
- Ndihmë për strehim ose investim në teknologji të gjelbër, pasi bankat po përfshijnë oferta me kusht që përmbushin standarde moderne.

Detyrë:

Vizitoni faqet zyrtare të bankave ose institucioneve financiare dhe identifikoni të paktën një produkt modern kredie (leasing, mikrokredi ose overdraft digjital), duke përshkruar shkurtimisht përfitimet dhe mënyrën e pagesës.

12.7. Veprimtari praktike: Analiza krahasuese produkteve të kredidhënies në tregun shqiptar

Udhëzime :

Hulumtoni në faqet zyrtare të bankave ose institucioneve të tjera kredidhënëse në Shqipëri (p.sh. Raiffeisen Bank, ProCredit Bank, Credins Bank etj) për të mbledhur informacion mbi llojet kryesore të kredive: konsumatore, biznesi dhe hipotekare.

Për çdo kredi, analizoni:

- ✓ Normën e interesit dhe çdo tarifë ose komision
- ✓ Afatin e shlyerjes
- ✓ Kriteret e aplikimit dhe garancitë e kërkuara
- ✓ Shërbimet shtesë që ofron banka (p.sh. mundësia e shlyerjes paraprake pa penaltete, shërbime online etj).

Përdorni të dhënat e mbledhura për të krijuar një tabelë krahasuese që tregon dallimet dhe përfitimet e secilit produkt, dhe më pas diskutoni për secilën kredi se për çfarë situatash mund të jetë më e përshtatshme.

Tema 13: Menaxhimi i likuiditetit të bankës

13.1 Kuptimi dhe rëndësia e likuiditetit bankar

Likuiditeti bankar përfaqëson aftësinë e një banke për të përmbushur detyrimet e saj financiare në kohë, pa pësuar humbje të konsiderueshme. Me fjalë të thjeshta, ai tregon se sa shpejt dhe lehtë mund të **kthehen** asetet e bankës në para të gatshme për të përballuar kërkesat e klientëve dhe nevojat e përditshme të veprimtarisë bankare.

Likuiditeti është thelbësor për funksionimin e çdo banke, sepse ajo punon kryesisht me fonde të depozituesve. Klientët kanë besim te banka se mund të tërheqin paratë e tyre në çdo moment. Nëse banka nuk arrin ta përmbushë këtë detyrim, humbet besueshmërinë dhe përballet me rrezik serioz për ekzistencën e saj.

Në praktikë, një bankë likuide është ajo që ka mjaftueshëm mjete monetare, si:

- para në arkë dhe në llogaritë rrjedhëse pranë Bankës së Shqipërisë,
- investime afatshkurtra që mund të shiten shpejt (p.sh. bono thesari),
- të ardhura të pritshme nga kthimi i kredive.

Nga ana tjetër, mungesa e likuiditetit ndodh kur banka nuk ka fonde të mjaftueshme për të përballuar kërkesat për tërheqje depozitash apo pagesat ndaj partnerëve. Kjo situatë mund të çojë në panik financiar dhe në humbje të reputacionit.

Rëndësia e likuiditetit qëndron në faktin se ai është shtylla e stabilitetit të sistemit bankar. Një bankë mund të jetë fitimprurëse, por nëse nuk ka likuiditet të mjaftueshëm, ajo nuk mund të kryejë funksionin e saj bazë: ndërmjetësimin financiar.

Për këtë arsye, bankat planifikojnë dhe monitorojnë çdo ditë gjendjen e likuiditetit përmes sistemeve të menaxhimit financiar dhe raporteve të posaçme të kërkuara nga Banka e Shqipërisë.

Në përfundim, likuiditeti bankar është një nga treguesit më të rëndësishëm të shëndetit financiar të një banke. Ai siguron besimin e klientëve, stabilitetin e sistemit dhe vazhdimësinë e shërbimeve bankare në çdo rrethanë.

13.2 Burimet e likuiditetit në bankë dhe menaxhimi i tyre

Likuiditeti i një banke nuk është i rastësishëm. Ai krijohet dhe ruhet përmes burimeve të ndryshme financiare që sigurojnë fluksin e nevojshëm të parasë për përmbushjen e detyrimeve të përditshme. Këto burime përbëjnë bazën mbi të cilën një bankë mban aftësinë për të operuar normalisht, për të dhënë kredi, për të përballuar kërkesat për tërheqje depozitash dhe për të ruajtur stabilitetin e saj financiar.

Një nga burimet më të rëndësishme të likuiditetit janë depozitat e klientëve, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të detyrimeve afatshkurtra të bankës. Këto depozita mund të jenë në formën e llogarive rrjedhëse, depozitave afatshkurtra ose afatgjata, dhe përfaqësojnë mjetet monetare që banka mund t'i përdorë për kreditim apo investime, duke ruajtur një pjesë të tyre si rezervë likuide.

Një tjetër burim i rëndësishëm janë kthimet e kredive të dhëna. Kur klientët shlyejnë këstet e kredive, banka rikuperon fondet që ka dhënë më parë dhe i përdor ato për të përmbushur kërkesat e tjera për likuiditet.

Po aq i rëndësishëm është investimi në instrumente financiare afatshkurtra, si bonot e thesarit apo certifikatat e depozitës, të cilat mund të shiten shpejt në treg nëse banka ka nevojë për para të gatshme. Këto investime janë të sigurt dhe mund të shiten shpejt për t'u kthyer në para të gatshme, ndaj konsiderohen pjesë e një menaxhimi të kujdesshëm të likuiditetit.

Në rast nevoje, bankat mund të sigurojnë likuiditet edhe përmes huamarrjes ndërbankare, ku marrin fonde për një periudhë të shkurtër nga banka të tjera. Ky mekanizëm i njohur si tregu ndërbankar, ndihmon në balancimin e përkohshëm të mungesës së fondeve.

Një burim tjetër i rëndësishëm është qasja në Bankën e Shqipërisë, ku bankat mund të marrin hua përmes operacioneve të tregut të hapur ose duke përdorur rezervat e tyre minimale të depozituara atje.

Në disa raste, likuiditeti mund të vijë edhe nga kapitalet e veta të bankës ose nga shitja e aktiveve jo thelbësore (p.sh. pasuri të paluajtshme apo pajisje), kur kërkohet përmirësim i menjëhershëm i gjendjes monetare.

Në përfundim, burimet e likuiditetit në bankë janë të shumta dhe të ndërlidhura, duke filluar nga depozitat e klientëve e deri te tregjet financiare. Aftësia e bankës për t'i përdorur me kujdes këto burime tregon nivelin e saj të menaxhimit financiar dhe është çelësi për ruajtjen e stabilitetit dhe besueshmërisë në sistemin bankar.

13.3 Shkaqet e mungesës së likuiditetit

Mungesa e likuiditetit është një nga problemet më serioze që mund të përballet një bankë pasi tregon se ajo nuk ka mjete të mjaftueshme monetare për të përmbushur detyrimet e saj të menjëhershme, si :

- tërheqjet e depozitave,
- pagesat ndaj furnitorëve ose
- transfertat ndërbankare.

Kjo situatë mund të shkaktohet nga një sërë faktorësh të brendshëm dhe të jashtëm, që ndikojnë në fluksin e parasë dhe në besueshmërinë e institucionit financiar.

Një nga shkaqet më të zakonshme është menaxhimi i dobët i aktiveve dhe detyrimeve. Kur banka nuk planifikon me kujdes përputhjen midis afateve të tyre, mund të krijohen boshllëqe likuiditeti. Për shembull, nëse banka jep kredi afatgjatë duke përdorur depozita afatshkurtra, krijohet një mospërputhje kohore, pasi fondet e dhëna për kredi nuk mund të kthehen shpejt në para të gatshme.

Një tjetër faktor i rëndësishëm është ulja e depozitave të klientëve. Kur klientët humbasin besimin te banka ose kanë nevojë të shtuara për para, ata mund të tërheqin depozitat e tyre në masë. Kjo situatë, e njohur si “vrap drejt bankës” (*bank run*), mund të shkaktojë mungesë të menjëhershme likuiditeti, edhe nëse banka është financiarisht e shëndetshme.

Gjithashtu, rritja e kredive me probleme (kur klientët nuk i shlyejnë detyrimet ndaj bankës në kohë) ndikon drejtpërdrejt në fluksin e parasë. Këto fonde mbeten të bllokuara dhe nuk mund të përdoren për të mbuluar kërkesat e tjera për likuiditet.

Përveç sa më sipër, edhe kushtet e pafavorshme në tregjet financiare mund të shkaktojnë mungesë likuiditeti. Në periudha krizash ekonomike ose pasigurie, tregjet mund të ngurtësohen dhe të bëhet e vështirë shitja e aktiveve ose sigurimi i huave ndërbankare, duke kufizuar aftësinë e bankës për të siguruar para të gatshme.

Një tjetër faktor është varësia e tepërt nga burimet afatshkurtra të financimit, të cilat duhet të rinovohen shpesh. Nëse bankat nuk arrijnë t'i rinovojnë këto burime në kohë, mbeten pa mjete likuide.

Në raste të veçanta, mungesa e likuiditetit mund të vijë edhe nga rritja e shpenzimeve operative ose menaxhimi joefikas i arkës, ku paratë nuk përdoren në mënyrë të balancuar midis nevojave të brendshme dhe atyre të jashtme.

Në këto kushte themi se mungesa e likuiditetit nuk është gjithmonë rezultat i mungesës së fitimit, por shpesh vjen nga planifikimi i dobët, rreziqet e tregut dhe sjellja e klientëve. Një bankë që nuk i monitoron këta faktorë rrezikon jo vetëm funksionimin e përditshëm, por edhe stabilitetin e saj afatgjatë në sistemin financiar.

13.4 Masat për ruajtjen e likuiditetit

Ruajtja e likuiditetit është një nga detyrat më të rëndësishme të çdo banke, pasi prej saj varet aftësia për të përballuar detyrimet ndaj klientëve dhe për të garantuar stabilitetin financiar. Një menaxhim i kujdesshëm i likuiditetit siguron që banka të ketë mjaftueshëm para të gatshme në çdo moment, pa penguar fitimprurjen apo aktivitetin e saj normal. Për të ruajtur likuiditetin financiar është e rëndësishme që të merren disa masa.

➤ **Planifikimi dhe menaxhimi strategjik i likuiditetit.**

Bankat duhet të hartojnë plane të qarta të menaxhimit të likuiditetit, ku përcaktohen burimet e financimit, kufijtë minimalë të mjeteve të disponueshme dhe mënyrat e reagimit ndaj mungesave të mundshme.

Këto plane përditësohen rregullisht në bazë të ndryshimeve në treg dhe në flukset financiare të bankës.

➤ **Mbajtja e rezervave të detyrueshme dhe fondeve likuide.**

Një nga masat kryesore është mbajtja e rezervave të mjaftueshme monetare, të njohura si rezerva të detyrueshme ose rezerva likuiditeti. Këto rezerva depozitohen në Bankën e Shqipërisë dhe shërbejnë si garanci për përballimin e kërkesave të menjëhershme për pagesa apo tërheqje depozitash. Pjesë e këtyre rezervave janë edhe fondet që mbahen në arkë ose në llogaritë rrjedhëse të bankës.

➤ **Diversifikimi i burimeve të fondeve.**

Banka nuk duhet të mbështetet vetëm te depozitat e klientëve. Ajo duhet të ketë akses edhe në tregun ndërbankar, në instrumente financiare afatshkurtra dhe linjat e kreditimit nga

institucione të tjera Kjo diversifikon rreziqet dhe siguron fleksibilitet në rast mungesash të papritura.

➤ **Monitorimi i treguesve financiarë të likuiditetit.**

Për të ruajtur likuiditetin, bankat monitorojnë vazhdimisht raportet financiare të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë, si raporti i aktiveve të disponueshme ndaj detyrimeve afatshkurtra dhe raporti kredi/depozita. Këta tregues u mundësojnë bankave të vlerësojnë nëse niveli aktual i likuiditetit është i mjaftueshëm për të përballuar detyrimet afatshkurtra.

➤ **Menaxhimi i kujdesshëm i kredive.**

Bankat duhet të sigurohen që kreditë e dhëna janë të rikuperueshme dhe nuk përbëjnë rrezik për flukset e likuiditetit. Për këtë qëllim, ato krijojnë fonde rezervë për kredi me probleme dhe shmangin ekspozimin e tepërt ndaj sektorëve me rrezik të lartë.

➤ **Planet emergjente për krizën e likuiditetit.**

Në raste emergjente, si tërheqje masive depozitash ose ngurtësim i tregut financiar, bankat duhet të kenë plane të gatshme reagimi. Kjo përfshin komunikimin me Bankën e Shqipërisë, përdorimin e fondeve rezervë, aktivizimin e huave afatshkurtra ose shitjen e aktiveve të tregtueshme.

Ruajtja e likuiditetit kërkon planifikim të vazhdueshëm, kontroll të kujdesshëm dhe reagim të shpejtë ndaj ndryshimeve në treg. Një bankë që arrin të mbajë ekuilibrin mes likuiditetit dhe fitimit siguron besueshmëri tek klientët dhe stabilitet afatgjatë në sistemin bankar.

13.5 Treguesit e likuiditetit bankar

Likuiditeti është një nga elementët më të rëndësishëm në funksionimin e një banke, sepse lidhet drejtpërdrejtë me aftësinë e saj për të përmbushur detyrimet ndaj klientëve dhe institucioneve të tjera financiare në çdo moment. Për të vlerësuar këtë aftësi, përdoren disa **tregues të likuiditetit bankar**, të cilët ndihmojnë menaxhmentin dhe autoritetet rregullatore të matin nëse banka është në gjendje të ruajë ekuilibrin ndërmjet aktiveve dhe pasiveve afatshkurtra. Këto tregues të likuiditetit banker janë :

- **Raporti i likuiditetit të menjëhershëm (Liquidity Ratio)** – i cili mat përqindjen e aktiveve likuide që banka zotëron në krahasim me detyrimet afatshkurtra. Formulë e thjeshtuar që përdoret është : **Likuiditeti = (Aktivet likuide / Detyrimet afatshkurtra) × 100**
Sa më i lartë të jetë ky raport, aq më e madhe është aftësia e bankës për të përballuar kërkesat e tërheqjeve të menjëhershme nga klientët.
- **Raporti i aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve** - i cili tregon se çfarë pjese e totalit të aktiveve përbëhet nga para në dorë, depozita në banka të tjera dhe letra me vlerë që mund të shiten shpejt në treg. Një përqindje e lartë tregon një strukturë më të qëndrueshme të likuiditetit.
- **Raporti kredi/depozita (Loan to Deposit Ratio)** – i cili është një nga treguesit më të përdorur nga bankat dhe autoritetet mbikëqyrëse. Formula me të cilën llogaritet është:
Raporti = (Totali i kredive / Totali i depozitave) × 100
Nëse raporti është shumë i lartë, do të thotë se pjesa më e madhe e depozitave është dhënë

në kredi dhe banka ka më pak rezerva për të përballuar tërheqje të papritura. Një raport i balancuar (zakonisht 70–80%) tregon menaxhim të kujdesshëm të likuiditetit.

- **Raporti i financimit afatgjatë (Stable Funding Ratio)** – i cili mat nëse banka mbështetet në burime të qëndrueshme financimi për të mbuluar aktivet afatgjata. Një nivel i ulët i këtij treguesi mund të tregojë varësi nga burime afatshkurtra, gjë që e rrit rrezikun e mungesës së likuiditetit.
- **Raporti i mbulimit të likuiditetit (Liquidity Coverage Ratio – LCR)**- i cili është një tregues ndërkombëtar i përcaktuar nga standardet **Basel III**. (Basel III është një kuadër ndërkombëtar rregullator që përcakton rregullat dhe standardet për funksionimin e bankave, me qëllim që ato të jenë më të sigurta, më të qëndrueshme dhe më rezistente ndaj krizave financiare). Ai kërkon që banka të mbajë mjaftueshëm aktive likuide me cilësi të lartë për të mbuluar daljet neto të parasë për 30 ditët e ardhshme në një situatë stresi financiar. Ky raport duhet të jetë $\geq 100\%$, që do të thotë se banka ka rezerva të mjaftueshme për t'u përballur me një periudhë të vështirë.
- **Raporti neto i financimit afatgjatë (Net Stable Funding Ratio – NSFR)**- i cili mat qëndrueshmërinë e strukturës së financimit në një horizont afatgjatë, zakonisht një vit. Ai synon të sigurojë që aktivet afatgjata të mbështeten nga burime të qëndrueshme financimi, si depozitat afatgjata apo kapitali.

Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se treguesit e likuiditetit janë mjete thelbësore për të garantuar qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e bankës. Analiza e tyre i ndihmon menaxherët bankarë të identifikojnë në kohë mungesat potenciale të likuiditetit dhe të ndërmarrin masa parandaluese përpara se situata të bëhet kritike. Një bankë me tregues të shëndetshëm likuiditeti gëzon besim më të madh nga klientët, investitorët dhe autoritetet rregullatore, duke ruajtur stabilitetin e sistemit financiar në tërësi.

13.6 Roli i Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në mbikëqyrjen e likuiditetit

Banka e Shqipërisë ka një rol kyç në sigurimin e stabilitetit financiar të vendit, duke mbikëqyrur likuiditetin e bankave tregtare dhe duke siguruar që ato të funksionojnë në mënyrë të shëndetshme dhe të qëndrueshme. Ajo vepron si autoritet rregullator dhe qendror, duke vendosur rregulla, standarde dhe mekanizma mbikëqyrjeje që synojnë parandalimin e mungesës së likuiditetit dhe ruajtjen e besimit të depozituesve.

Një nga mjetet kryesore të Bankës së Shqipërisë është vendosja e rezervave detyruese. Sipas ligjit, çdo bankë tregtare duhet të mbajë një pjesë të depozitave të klientëve në llogari pranë Bankës Qendrore. Këto rezerva mund të përdoren menjëherë në rast mungese likuiditeti, duke garantuar që banka mund të përmbushë pagesat e afatit të shkurtër pa probleme.

Banka e Shqipërisë gjithashtu monitoron raportet e detyrueshme të likuiditetit, si raporti i aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra, raporti kredi/depozita, si dhe treguesit e standardeve ndërkombëtare të Basel III, si p.sh raportin e mbulimit të likuiditetit. Ky monitorim i lejon Bankës

Qendrore të identifikojë në kohë rreziqet e likuiditetit dhe të kërkojë masa korrigjuese nga bankat për të parandaluar krizën.

Në rastet e krizave të përkohshme, Banka e Shqipërisë mund të ofrojë likuiditet emergjent për bankat që përballen me mungesa të përkohshme të fondeve. Ky proces kryhet në mënyrë të kontrolluar dhe me garanci, duke siguruar që sistemi bankar të mos destabilizohet dhe që depozituesit të mos humbasin besimin tek bankat.

Një funksion shtesë i rëndësishëm është roli i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD), e cila siguron mbrojtjen e depozitave të klientëve deri në një kufi të caktuar. Kjo rrit besimin e publikut te bankat dhe kontribuon në stabilitetin e përgjithshëm të sistemit financiar, duke i garantuar depozituesve që fondet e tyre janë të mbrojtura edhe në rast situatash të papritura.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë rregullon normat e interesit dhe politikat monetare, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në qarkullimin e parasë dhe në likuiditetin e bankave. Banka Qendrore mund të përdorë instrumente si operacionet e tregut të hapur, normat e repo dhe reverse repo, dhe politikën e rezervave detyruese për të menaxhuar flukset monetare në sistem.

Në përfundim, Banka e Shqipërisë dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave veprojnë së bashku si garantë të stabilitetit të sistemit bankar, duke mbikëqyrur dhe kontrolluar likuiditetin e bankave tregtare, duke vendosur rregulla dhe standarde, dhe duke ofruar mekanizma emergjentë për të parandaluar krizën financiare. Pa këtë mbikëqyrje, bankat nuk mund të funksiononin në mënyrë të besueshme dhe depozituesit nuk do të ndiheshin të sigurtë për paratë e tyre.

13.7 Menaxhimi i riskut të likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është mundësia që një bankë të mos ketë fonde të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e saj financiare në kohë. Menaxhimi i këtij rreziku është një nga detyrat kryesore të menaxhmentit bankar, sepse mungesa e likuiditetit mund të çojë në përplasje financiare, humbje të besueshmërisë dhe destabilizim të bankës.

Menaxhimi i riskut fillon me identifikimin e burimeve të tij. Bankat analizojnë strukturën e aktiveve dhe pasiveve, maturimin e kredive dhe depozitave, dhe flukset e pritshme të parasë për të parashikuar situatat që mund të krijojnë mungesa likuiditeti.

Një masë e rëndësishme është diversifikimi i burimeve të fondeve. Banka nuk duhet të mbështetet vetëm te depozitat e klientëve ose te financimi afatshkurtër nga tregu ndërbankar, por të ketë edhe investime afatshkurtra të lëngshme, linja kreditimi të sigurta, dhe fonde rezervë për situata emergjente. Kjo i jep fleksibilitet për t'u përballur me tërheqje të papritura ose krizë në treg.

Bankat përdorin instrumente të matjes dhe kontrollit të rrezikut, si:

- analiza e treguesve të likuiditetit,
- vlerësimi i stresit të tregut financiar (*stress testing*),
- skenarët e krizave të mundshme,

Këto mjete i ndihmojnë bankës të kuptojë pasojat e mungesës së fondeve dhe të marrin masa parandaluese.

Një komponent kyç është planifikimi emergjent i likuiditetit, që përfshin masa konkrete që banka duhet të ndërmarrë në rast të mungesës së likuiditetit, si shitja e aktiveve të tregtueshme, sigurimi i huave emergjente, ose koordinimi me Bankën Qendrore.

Gjithashtu, bankat ndjekin politikën e mbajtjes së rezerva të mjaftueshme likuide, për të garantuar aftësinë për të përballuar kërkesat e papritura për para. Kjo politikë është pjesë e strategjisë më të gjerë të menaxhimit të rrezikut dhe kontribuon në stabilitetin e bankës.

Në këto kushte themi se menaxhimi i riskut të likuiditetit është një kombinim i planifikimit, monitorimit dhe marrjes së masave parandaluese. Një bankë që arrin të menaxhojë këtë risk ruan besimin e klientëve, siguron stabilitetin financiar dhe është e përgatitur të përballlet me ndryshime të paparashikuara në tregun financiar.

13.8 Ndikimi i menaxhimit të likuiditetit në stabilitetin financiar të bankës

